



# USHTRIA



Viti i 76-të i botimit Nr. 7 (827811)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 17 shkurt 2023

## Policia Ushtarake e FA-së, e gatshme në realizimin e misioneve dhe detyrave

Ky është viti i 31-të që kur Policia Ushtarake u krijua si strukturë përbërëse e Forcave të Armatosura, si një nevojë por edhe domosdoshmëri e tyre. Së bashku me transformimin domethënës të Forcave tona të Armatosura, pas viteve 1990 e deri më sot, Policia Ushtarake tashmë vjen si një strukturë elitare ushtarake, e mirë pajisur, e trajnuar dhe po ashtu tepër e vlerësuar në

të gjithë zinxhirin e drejtimit dhe të komandimit të saj për aftësimin dhe kryerjen e detyrës. Sot Policia Ushtarake drejtohet nga kolonel Shkëlqim Çela, ushtarak me karrierë të spikatur në Forcat e Armatosura, i cili gjatë rrugëtimit të tij ushtarak ka kryer një sërë detyrash, që nga pedagog në AFA "Skënderbej", komandant toge e instruktor stërvitje në Regjimentin Komando, koman-

dant i Shkollës të Zbulimit, oficer shtabi për Planifikimin në J-2, shefi i Degës së Zbulimit në FT, komandant i Batalionit Komando, shefi i Kabinetit të SHSHPFA, komandant i QBO-së, komandanti i QS në KM, drejtori i Personelit në SHPFA, drejtori Menaxhimit Burimeve Njerëzore MM, shefi i Shtabit në KM, etj. Kolonel Çela ka gjithashtu një formim... » faqe 6



## Takimi i Ministrave të Mbrojtjes të NATO-s Ministri Peleshi: Vijimi i ndihmës për Ukrainën, me rëndësi për sigurinë e Aleancës



Meetings of NATO Ministers of Defence

14-15 II 2023

Réunions des ministres de la défense de l'OTAN



» faqe 3

U zhvillua ceremonia e përvitimit të monumentit në nderim të dëshmorëve të Fekenit

Në Parkun Orbital në Farkë, u zhvillua ceremonia e përkujtimit dhe përvitimit të monumentit në nderim të Dëshmorëve të Fekenit. Në këtë ceremoni morën pjesë Ministri i Mbrojtjes, Zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA-së, komandantët e Forcave e reparteve autonome, nënkryetarë të Bashkisë Tiranë, përfaqësues të ushtarakëve në rezervë e lirim si dhe familjarë të dëshmorëve. Ministri i Mbrojtjes, gjatë fjalës së tij vlerësoi aktin e dëshmorëve...



» Faqe 2

Gjeneral brigade Kingji dhe ambasadorja Yuri Kim inspektojnë punimet për rinovimin e tuneleve

Shef i Shtabit të Përgjithshëm, Gjeneral brigade Arben Kingji, i shoqëruar nga ambasadorja amerikane, zj. Yuri Kim, inspektuan punimet për rinovimin e tuneleve që do të shërbejnë si depo të municionit, projekt i financuar nga Komanda Evropiane e SHBA-së (EUCOM), nëpërmjet Programit Humanitar të Minave. Falë kësaj mbështetjeje është bërë e mundur ngritja e kapaciteteve për Asgjësimin e Minave Shpërthyes (trajnimi për personelin EOD në të tre nivelet, mbështetja me pajisje dhe mjete)...



» Faqe 3

14 shkurt 1969, krijohet Batalioni i Vëzhgimit Ajror

Forcat Ajrore Shqiptare janë një nga tre armët e Forcave të Armatosura Shqiptare. Forca Ajrore përbëhet nga Komanda dhe Shtabi i Faj-së, Baza Ajrore Farkë, Baza Ajrore Kuçovë, Qendra e Vëzhgimit Ajror, Shërbimi Meteorologjik Ushtarak dhe Kompania e Mbështetjes e Faj-së. Përpjekjet për krijimin e Armës së Aviacionit janë të hershme. Qeveritë e para Luftës së Dytë Botërore, me gjithë përpjekjet, nuk arritën ta realizojnë një gjë të tillë, kryesisht për arsye ekonomike. Hapi i parë për të krijuar një Aviacion Ushtarak në Shqipëri...



» Faqe 4

Në Parkun Orbital në Farkë, Tiranë, u zhvillua ceremonia e përkujtimit dhe përvurimit të monumentit në nderim të Dëshmorëve të Fekenit.

Në këtë ceremoni morën pjesë Ministri i Mbrojtjes, Zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA-së, komandantët e Forcave e reparteve autonome, nënkryetarë të Bashkisë Tiranë, përfaqësues të ushtarakëve në rezervë e lirim si dhe familjarë të dëshmorëve.

Ministri i Mbrojtjes, gjatë fjalës së tij vlerësoi aktin e dëshmorëve të Fekenit dhe në respekt të tyre ftoi pjesëmarrësit të mbanin një minutë heshtje. Gjithashtu, aktiviteti u vlerësua edhe nga ish-presidenti Bamir Topi, si dhe u përshëndet nga përfaqësues të familjarëve, ish-studentë e kolegë të të rënëve.

Në fjalën e tij, komandanti AFA-së, gjeneral brigade Bilbil Bitri citoi: "Ndjehem thellësisht i nderuar që jam në këtë ceremoni, për të kujtuar së bashku me të gjithë ju "11 Dëshmorët e Tragjedisë së Fekenit". Komandant Dushanin, shef Çlirimin, pedagog Nikollaqin, student Alekon, Besnikun, Bilbilin, Ilirin, Bujarin, Pëllumbin, Qemalin dhe Nexhipin".

Për ngritjen e Memorialit të dëshmorëve të Fekenit Akademia e Forcave të Armatosura u mbështet nga Shtabi i Përgjithshëm i FA-së, Bashkia Tiranë, Komanda Mbështetëse si dhe kolegë të dëshmorëve.

Ceremonia u mbyll duke vendosur kurora dhe buqeta me lule në nderim të dëshmorëve.

# U zhvillua ceremonia e përvurimit të monumentit në nderim të dëshmorëve të Fekenit



# Forca Tokësore vijon bashkëpunimin me Gardën Kombëtare të New Jersey-it, SHBA

Ekspertët ushtarakë amerikanë të Gardës Kombëtare të New Jersey-it (GKNJ), trajnuan efektivët e Forcës Tokësore, në tre fusha të rëndësishme për ruajtjen dhe rritjen e kapaciteteve operacionale: mortajat 120 mm, radiot "Harris Type One", mirëmbajtja e mjeteve tip HMMWV. Programi i trajnimit u zbatua në bazë të planit të bashkëpunimit dypalësh midis Gardës Kombëtare të New Jersey-it me efektivat e Grup Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë (GBKL).

ëllimi i këtij trajnimi ishte rritja e aftësive profesionale ushtarake, të efektivëve të GBKL për përdorimin operacional të mortajave, mjeteve të komunikimit dhe mirëmbajtjen e mjeteve të blinduara.

Ndër temat kryesore, që u trajtuan për rreth një javë në këtë aktivitet stërvitor, ishin: llojet e municioneve të mortajave 81mm dhe 120mm, thirrje zjarri me mortajë 81mm dhe 120mm, njohuri aparature dhe të dhënat teknike të radio stacioneve të



ndryshme të shërbimit të ndërlidhjes, kontrolli dhe eliminimi i defekteve të mundshme të makinave tip HMMWV si eliminimi i rrjedhjeve (ujë, vaj, naftë), kontrolli i grupit të timonit dhe sistemit të drejtimit etj.

Teoria e ndërthurur me veprimet praktike në terren, bënë që efektivët e

GBKL të merrnin jo vetëm njohuritë e duhura, por edhe të aftësoheshin në përdorimin praktik të armëve, aparaturave dhe mjeteve të transportit.

Ky trajnim vjen si vijimësi e një bashkëpunimi të shkëlqyer, që prej vitesh Forca Tokësore ka me Gardën Kombëtare të New Jersey-it, SHBA.



Në përfundim të trajnimit, zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ferdinant Dimo, priti në një takim të veçantë instruktorët e GKNJ, ku iu shprehu falënderimet dhe mirënjohjen e tij për punën e mirë, në drejtim të rritjes profesionale të efektivëve të

Forcës Tokësore.

Gjeneral brigade Dimo i akordoi rreshterit Toby Tirrito, instruktor për radiot "Type One", një certifikatë mirënjohjeje për kontributin e tij disa vjeçar në drejtim të trajnimit të personelit të shërbimit ndërlidhës të Forcës Tokësore.

STAFI

**ANJEZA MUSOLLARI**  
Shefe e Sektorit të  
Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:  
Mimoza **GOLIKJA**

Redaktore/ korrektore:  
Suela **HODA**

Graphic Designer:  
Afërdita **HYSAJ**

ADRESA:  
Rruga e Dibrës/  
Garnizoni "Skënderbej"

TAKIMI I MINISTRAVE TË MBROJTJES TË NATO-S

# Ministri Peleshi: Vijimi i ndihmës për Ukrainën, me rëndësi për sigurinë e Aleancës

**M**inistri i Mbrojtjes Niko Peleshi mori pjesë në Takimin dyditor të Ministrave të Mbrojtjes të vendeve të Aleancës, që u mbajt në selinë e NATO-s në Bruksel.

Fokusi i diskutimeve ishte lufta në Ukrainë, e cila javën që vjen shënon 1-vjetorin e fillimit të saj. Përfaqësuesit e lartë të vendeve të Aleancës theksuan nevojën urgjente për më shumë mbështetje me sisteme armatimi, tanke, artileri dhe municione të kalibrave të ndryshëm me qëllim mbrojtjen e Ukrainës nga agresioni rus.

Këto çështje u adresuan edhe gjatë takimit të veçantë të Grupit të Kontaktit për Mbrojtjen e Ukrainës, që u mbajt para fillimit të Takimit të Ministrave të Mbrojtjes, në selinë e NATO-s, ku pjesë ishte gjithashtu edhe ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi. Sekretari i Përgjithshëm i Aleancës z. Jens Stoltenberg theksoi rëndësinë e rritjes së furnizimeve me armatim dhe municione për Kievin, në një kohë mjaft kritike për fatin e luftës atje.

Vëmendje të veçantë mori edhe forcimi i elementëve të parandalimit dhe mbrojtjes së NATO-s, si dhe ngritja dhe zhvillimi i industrive të prodhimit të armatimit dhe municioneve të vendeve të Aleancës, me qëllim kompensimin e armatim - municioneve të dërguara në Ukrainë, por edhe për të shtuar rezervat e aleatëve.

Ministri i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi, veç pjesëmarrjes në Takimin e Ministrave të Mbrojtjes dhe në Takimin e Grupit të Kontaktit për Ukrainën, mori pjesë edhe në Takimin



e Ministrave të Mbrojtjes së vendeve kontribuuese në Grup-Batalionin e drejtuar nga Kanadaja në Letoni.

Ministri Peleshi e vlerësoi këtë takim si mjaft të rëndësishëm, në një moment tepër kritik për mbrojtjen

dhe sigurinë e Aleatëve. Po ashtu, ministri Peleshi cilësoi të rëndësishme edhe ndihmën e vazhdueshme për Ukrainën, duke vlerësuar popullin ukrainas për kurajën dhe vendosmërinë e treguar, si dhe lidhshimin e qe-

verisë, ndërsa po i afrohem përvjetorit të parë të fillimit të luftës.

Ky takim shërbeu edhe për hapjen e diskutimeve dhe çështjeve që priten të trajtohen gjatë Samitit të NATO-s, që do të mbahet në Vilnius, Lituani,

më 11 - 12 korrik të këtij viti. Gjatë takimeve në Bruksel, ministri Peleshi i shprehu ngushëllime homologut turk, për jetët e humbura nga tërmeti shkatërrues që preku Turqinë dhe Sirinë javën e kaluar.

## Gjeneral brigade Kingji dhe ambasadorja Yuri Kim inspektojnë punimet për rinovimin e tuneleve

Shef i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji, i shoqëruar nga ambasadorja amerikane, zj. Yuri Kim, inspektuan punimet për rinovimin e tuneleve që do të shërbejnë si depo të municionit, projekt i financuar nga Komanda Evropiane e SHBA-së (EUCOM), nëpërmjet Programit Humanitar të Minave.

Falë kësaj mbështetjeje është bërë e mundur ngritja e kapaciteteve për Asgjësimin e Minave Shpërthyes (trajnimi për personelin EOD në të tre nivelet, mbështetja me pajisje dhe mjete), rikonstruksioni depove/tuneleve të sigurta të magazinimit të municioneve, si dhe trajnimi i personelit që merret me menaxhimin e municioneve.



# 14 shkurt 1969, krijohet Batalioni i Vëzhgimit Ajror

**F**orcat Ajrore Shqiptare janë një nga tre armët e Forcave të Armatosura Shqiptare. Forca Ajrore përbëhet nga Komanda dhe Shtabi i Faj-së, Baza Ajrore Farkë, Baza Ajrore Kuçovë, Qendra e Vëzhgimit Ajror, Shërbimi Meteorologjik Ushtarak dhe Kompania e Mbështetjes e Faj-së.

Përpjekjet për krijimin e Armës së Aviacionit janë të hershme. Qeveritë e para Luftës së Dytë Botërore, me gjithë përpjekjet, nuk arritën ta realizojnë një gjë të tillë, kryesisht për arsye ekonomike.

Hapi i parë për të krijuar një Aviacion Ushtarak në Shqipëri, u hodh më 1914, kur qeveria shqiptare porositi blerjen e tre avionëve "Lohner Daimler" nga Austria për të formuar Korpusin Ajror Shqiptar. Si rezultat i Luftës së Parë Botërore, urdhri u anulua dhe gjatë viteve 1920-1930, Shqipëria nuk kishte burimet e nevojshme për të rifilluar zhvillimin e një Force Ajrore. Përpjekjet e para për të blerë aeroplanë dhe për të krijuar një Forcë Ajrore rifilluan përsëri në fundin e viteve '30, kohë në të cilën kadetë për pilot u dërguan për studime në Austri, Itali dhe Francë.

Aviacioni Luftarak Shqiptar është krijuar pas Luftës së Dytë Botërore dhe data zyrtare e krijimit të tij është 24 prilli i vitit 1951. Edhe Vëzhgimi i Hapësirës Ajrore është institucionalizuar pas luftës. Më 14 shkurt të vitit 1947 është krijuar kompania e VAIN-it për vrojtimin e hapësirës ajrore dhe informimin për objektet e zbuluara.

Grupimi i parë i avionëve luftarakë është bërë në Tiranë, në vitin 1951, ku bënin pjesë avionë PO-2 dhe JAK-18.

Reparti i parë i Aviacionit Reaktiv është krijuar në vitin 1955 në Kuçovë dhe kishte në përbërje të tij avionë MIG-15.

Në vitin 1957 krijohet Reparti i Transportit Ushtarak në Tiranë, i cili kishte në përbërjen e tij avionë Po-2, JAK-18 dhe helikopterë MI-1 dhe MI-4.

Në vitin 1962 u krijua Regjimenti i Aviacionit në Rinas, i cili kishte në përbërjen e tij një skuadrilje me avionë MIG-19 dhe një skuadrilje me avionë MIG-17. Po në vitin 1962 krijohet edhe Shkolla e Aviacionit.

Në vitin 1967 krijohet Regjimenti i Helikopterëve, që numëronte në parkun e tij mbi 30 helikopterë të rinj MI-4.

Në vitin 1974 krijohet Regjimenti i Gjadrit, i cili ishte i pajisur me avionë MIG-21 dhe MIG-19, përveç disa avionëve mësimorë MIG-17 e MIG-15 për trenerim.

Në vitet '70 Aviacioni Luftarak kishte në efikasitet të plotë mbi 70 avionë MIG-19 dhe 12 avionë MIG-21, një skuadrilje luftarake me MIG-17 dhe shumë avionë luftarakë-mësimorë të tipit MIG-15. Pjesë e parkut ushtarak të avionëve ishin edhe katër avionë transporti IL-14, të cilët shërbenin si avionë për transport qeveritar apo për studime ushtarake e gjeografike.

Në Tiranë, në fushën e Laprakës ishin të dislokuar edhe 12 avionë transporti të lehtë AN-2, që shërbenin për transport trupash dhe në ndihmë



të ekonomisë. Në Shkollën e Lartë të Aviacionit në Vlorë, veç avionëve reaktivë MIG-15, kishte gjithashtu edhe dy skuadrilje me avionë me helikë JAK-81, të cilët shërbenin për përgatitjen e pilotëve në vitin e parë të kualifikimit si pilot. Në Regjimentin e Rinasit kishte gjithashtu edhe një avion bombardues të lehtë tip IL-28.

Në vitet '70-'80 niveli i programimit të fluturimeve ishte intensiv dhe sasia e fluturimeve për çdo pilot e avion ishte i standardeve e kërkesave të larta. Pas viteve 2000, në Forcat Ajrore filloi prurja e teknikës fluturuese Perëndimore.

Në prill të vitit 2001 erdhën helikopterët e parë AB-206, ndërsa më 26 nëntor 2003 është kompletuar një skuadrilje e tillë.

- Më 24 prill 2004 erdhi helikopteri i parë AB-205.

- Më 1 shkurt të vitit 2007 erdhi helikopteri për transport VIP A - 109.

- Më 18 qershor 2007 erdhën helikopterët e parë BO - 105.

- Më 28 korrik 2012 erdhi helikopteri EC-145, i versionit VIP.

- Më 3 dhjetor 2012 erdhi helikopteri i parë shumë-funksional tip "Cougar".

Më 25 prill 2013, vjen helikopteri i dytë shumë-funksional tip "Cougar".

Më 18 dhjetor 2013, vjen helikopteri i tretë shumë-funksional tip "Cougar".

Më 27 tetor 2014, është futur në përdorim të Forcës Ajrore helikopteri

i katërt tip "Cougar".

Më 31 tetor 2015, hyjnë në përdorim në FA dy helikopterë EC-145.

Mbrojtja Kundërajrore dhe Aviacioni janë "takuar e ndarë" disa herë nga forma organizative, por bashkëpunimi i tyre ka qenë gjithnjë i pashkëputur. Në fillimet e saj, arma e Aviacionit ka qenë pjesë e Komandës së Mbrojtjes Kundërajrore, gjë që ka vazhduar deri në vitin 1974 për t'u bashkuar përsëri në Forcat e Mbrojtjes Ajrore në vitin 1995. Komandanti i parë i Aviacionit ka qenë zoti Edip Ohri, i cili e ka komanduar atë deri në vitin 1974. Nga viti 1975 e deri në vitin 1995, komandantë të Aviacionit kanë qenë Bardhyl Taçi, Klement Aliko, Perlat Binaj.

Shumë ushtarakë të këtyre armëve, që kanë drejtuar e punuar në vite, janë nga figurat më të shquara të ushtrisë sonë, ku përmendim Rrahman Parlaku, Gjin Marku, Hito Çako, Todi Naço, Sotir Filto, Arif Hasko, Edip Ohri, Niko Hoxha, Babaçe Faiku, Bardhyl Taçi, Klement Aliko, Haki Jupasi, Perlat Binaj, Salih Dibra, Haki Jupasi, Stefan Kagjini, Lulo Musai, Perikli Teta, Foto Lako, Harilla Rebi, Perlat Sula, gjeneral brigade Astrit Jaupi, etj., të cilët kanë qenë të njohur në të gjithë radhët e ushtrisë për kryerjen e detyrave.

Mbrojtja Kundërajrore, Aviacioni Luftarak dhe repartet e Vëzhgimit të Hapësirës Ajrore pavarësisht nga format organizative të ndryshme në vite



Ajrore.

Siç dihet, në aktin ligjor të datës 1 korrik 1931 "Mbi organizimin e Ushtrisë Kombëtare" u sanksionua vendosja e tre baterive të para kundërajrore në vendin tonë në portet e Shëngjinit, Durrësit e Sarandës, datë e cila është edhe dita e krijimit zyrtar të kësaj arme.

Më 14 nëntor 1947 krijohet regjimenti i parë i Artilerisë Kundërajrore (AKA) në Tiranë, pasi ishte bërë më parë përqendrimi i kësaj njësie në ish-Shkollën e Instruksionit të Artilerisë në Kavajë, ku u grumbulluan topat kundërajrorë 29mm, 37mm dhe 40mm, tre bateri kalibër 76mm dhe një bateri e kalibrit 85mm.

Më 24 maj 1948 regjimenti mori emrin "Ali Demi". Në gusht të po atij viti efektivat e regjimentit rrëzuan një avion tip "Spitfire".

Në vitet 1954-1955 regjimenti u pajis me bateri KA-85mm e mjete radioteknike më të sofistikuara, ndërsa në vitet 1957-1958 u pajis me bateri 57mm dhe 100mm. Në vitet 1959-1969, në armatim futen edhe raketat e drejtuara, topat AKA-37mm, topat 57mm dhe 100mm me drejtim automatik, mitralozat 14,5mm me katër tyta, ndërkohë që MKA u pajis edhe me radarë të zbulimit të largët, të mesëm, të afërt. Nga kjo njësi, pas plotësimit vit pas viti me teknikë luftarake kanë dalë një numër i madh kuadrosh drejtues, por edhe reparte të reja, që janë shtrirë më pas në të gjithë vendin. Në vitet '70 kishte 22 regjimente të AKA-së, 18 batalione mitraljerë AKA, që llogarisnin rreth 6 gryka zjarri për çdo kilometër të frontit.

Regjimenti i Raketave të Drejtuara



automatik, mitralozat 14,5mm me katër tyta, dhe me radarë të zbulimit të largët, të mesëm, të afërt. Regjimenti i Raketave të Drejtuara Kundërajrore, që konsiderohej si krenaria e kësaj arme është krijuar më 6 dhjetor të vitit 1968. Në vitet '70 kishte 22 regjimente të AKA-së, 18 batalione mitraljerë AKA, që llogarisnin rreth 6 gryka zjarri për çdo kilometër të frontit.

Qendra e Vëzhgimit Ajror u krijua në gusht të vitit 2010, si rezultat i implementimit të strukturës së re të Forcës Ajrore. Vend dislokimi i saj është në Rinas.

Qendra e Vëzhgimit Ajror është pasues i Batalionit të Mbrojtjes

Kundërajrore që konsiderohej si krenaria e kësaj arme është krijuar më 6 dhjetor të vitit 1968, pasi kishte bërë një demonstrim të kësaj teknike në paradën ushtarake të vitit 1964.

Figura të shquara ushtarake kanë komanduar Regjimentin e Artilerisë si: Muharrem Shabani, Simo Dharmo, Atif Ruci, Raqi Iftica, Siri Strazimiri, Savo Kavaja, Kiço Janku, Naun Gjiniqasi, Maqo Zoto, Bejto Isufi, Pasho Zhupa, Qendro Mustafaraj, Alush Bisha, Namik Shehu, Ferhat Turhani, Pëllumb Gjonedaj, Metan Ismaili, Vangjel Mati, Xhevdet Ramçaj, Hiqmet Zyberi, Rustem Lami, Arqile Kokëdhima, Mehmet Mehmetaj, Tomorr Mukaj.



## Fillon Kursi për Sigurinë Fizike dhe Menaxhimin e Municioneve, Niveli II

Në Qendrën Stërvitore të Komandës Mbështetëse, filloi Kursi për Sigurinë Fizike dhe Menaxhimin e Municioneve, Niveli II, me pjesëmarrjen e 20 kursantëve (10 kursantë nga strukturat e FA-së, 10 kursantë nga Kosova).

Ky kurs do të vazhdojë deri

më datë 03 mars 2023.

Në ceremoninë e fillimit të kursit morën pjesë përfaqësues nga Komanda Amerikane në Evropë USEUCOM, komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, ODC, përfaqësues të SHPPFA, si dhe komandanti i Qendrës Stërvitore, kolonel Ylli Zylaj.

Në fjalën e hapjes, kolonel Zylaj nënvizoi se qëllimi i këtij kursi është thellimi i njohurive të instruktorëve me standardet më të mira ndërkom-bëtare për sigurinë me municionet dhe lëndëve plasëse që përdoren nga personeli ushtarak, si dhe theksoi që ky kurs do të zhvillohet nën drejtimin e instruktorëve amerikanë.



Ndërsa znj. Mari Kokotajlo në fjalën e saj theksoi rëndësinë e bashkëpunimit midis dy vendeve dhe ushtrive tona. "Shqipëria dhe Kosova, - vijoi më tej ajo, - janë dy vende mike të SHBA-ve dhe kjo është arsyeja që ne kemi zgjedhur të

investojmë në trajnim dhe siguri për një të ardhme me të mirë".

Ceremonia u mbyll me një foto të përbashkët dhe dhënien e një dhurate simbolike nga komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia.



## Batalioni i Xhenios dhe Shkolla e Trupës së KM vizitohet nga përfaqësues të Pentagonit, US EUCOM, HMA AFRICOM dhe ODC

Një ekip amerikan, në përbërjen e të cilit ishin përfaqësues të Pentagonit, US EUCOM, HMA AFRICOM dhe ODC, të shoqëruar nga komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia dhe drejtori J4, kolonel Aleksandër Pando, vizituan Batalionin e Xhenios, ku u njohën me pajisjet EOD dhe IEDD që SHBA-ja ka dhuruar ndër vite për kompaninë EOD. Ata u njohën nga afër me këto pajisje si dhe ndoqën demonstrimin nga operatorët EOD në përdorimin e tyre.

Gjithashtu ky ekip inspektoi dhe tunelet e municionit, të cilat janë rishturuar së fundmi nga firma "Goldenwest" me fonde amerikane nëpërmjet projektit HMA.

Në vazhdim të vizitës së tij ekipi inspektoi klasat EOD dhe të armatimit - municionit, në Shkollën e Trupës së KM-së, të rinovuara edhe këto me projektin HMA.



Më pas nga kursantët EOD u bë një demonstrim mbi detyrat dhe përgjegjësitë që ka operatori EOD, pas përfundimit të kursit, bazuar kjo në kualifikimin e tyre dhe njohuritë e përfituara në kursin EOD.

Në përfundim të vizitës komandanti i KM shprehu mirënjohjen e tij për palën amerikane për gjithë këtë punë si dhe falënderoi efektivat për përkushtimin në detyrën e tyre të vështirë.

### Specialistët EOD të Batalionit të Xhenios në KM, kontribut i çmuar në ruajtjen e sigurisë

*Gjatë kryerjes së punimeve për sistemin e rrugës në zonën e ish - doganës, punonjësit kanë hasur në një municion luftarak të paplasur.*

*Specialistët EOD të Batalionit të Xhenios në KM, me marrjen e njoftimit kanë shkuar në vend dhe në masa të larta sigurie kanë bërë të mundur evidentimin dhe largimin e municionit të paplasur nga zona e punimeve, duke dëshmuar dhe njëherë profesionalizëm në detyrën e tyre.*

*Municioni i gjetur ishte predhë artilerie 150 mm. Më pas municioni u magazinua dhe operacioni përfundoi me sukses.*

*Në këtë operacion morën pjesë 5 specialistë EOD si dhe efektivë të Policisë Ushtarake.*



INTERVITË ME KOLONEL SHKËLQIM ÇELA

# Policia Ushtarake e FA-së, e gatshme në realizimin e misioneve dhe detyrave

Intervistoi: MIMOZA GOLIKJA

**K**y është viti i 31-të që kur Policia Ushtarake u krijua si strukturë përbërëse e Forcave të Armatosura, si një nevojë por edhe domosdoshmëri e tyre. Së bashku me transformimin domethënës të Forcave tona të Armatosura, pas viteve 1990 e deri më sot, Policia Ushtarake tashmë vjen si një strukturë elitare ushtarake, e mirë pajisur, e trajnuar dhe po ashtu tepër e vlerësuar në të gjithë zinxhirin e drejtimit dhe të komandimit të saj për aftësimin dhe kryerjen e detyrës.

Sot Policia Ushtarake drejtohet nga kolonel Shkëlqim Çela, ushtarak me karrierë të spikatur në Forcat e Armatosura, i cili gjatë rrugëtimit të tij ushtarak ka kryer një sërë detyrash, që nga pedagog në AFA "Skënderbej", komandant toge e instruktor stërvitje në Regjimentin Komando, komandant i Shkollës të Zbulimit, oficer shtabi për Planifikimin në J-2, shefi i Degës së Zbulimit në FT, komandant i Batalionit Komando, shefi i Kabinetit të SHSHPFA, komandant i QBO-së, komandanti i QS në KM, drejtori i Personelit në SHPFA, drejtori Menaxhimit Buri-meve Njerëzore MM, shefi i Shtabit në KM, etj.

Kolonel Çela ka gjithashtu një formim të spikatur ushtarak, ai ka kryer Akademinë Ushtarake në Tiranë, Akademinë e drejtimit në Gjermani, ka kryer gjithashtu një numër kursesh dhe trajnimesh në Gjermani, si Kursin e Liderit, "George Marshall Center", kursin e oficerit të Shtabit të NATO-s, kursin e NATO-s për Antiterrorizmin, kursin e oficerit të Shtabit të OKB, Kolegjin për Politikën e Sigurisë dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare, "George Marshall Center" Gjermani, si dhe një numër kursesh e seminaresh të tjera lidhur me Trafikimin e qenieve njerëzore, Këshilltarët ligjorë të NATO-s, Bashkëpunimin rajonal, Armë-kontrollin etj. Kolonel Çela ka marrë pjesë në disa misione si në misionin "Liria e Irakut" në 2007, në misionin ISAF në RC Herat, Afganistan në 2013, si dhe në zyrën e NATO-s në Gjeorgji, si këshilltar për planifikimin strategjik. Ai ka gjithashtu një diplomë të Universitetit të Tiranës në degën Juridik. Në 31-vjetorin e Policisë Ushtarake komandanti i saj, kolonel Shkëlqim Çela sjell për shtypin ushtarak historikun dhe arritjet dhe objektivat e kësaj force elitare të FA-së.

**Kolonel Çela, sapo keni kremtuar 31-vjetorin e krijimit të Policisë Ushtarake që ju sot drejtoni. Si është të jesh Komandant i kësaj strukture? Si erdhi institucioni juaj në këtë përvjetor?**

Policia Ushtarake festoi 31-vjetorin e krijimit dhe kremtimi i kësaj feste jubilarë mbart në vetvete krenarinë dhe peshën e 31 viteve histori, punë, përpjekje dhe sakrificë, gjë që më jep mua si Komandant kënaqësinë e veçantë të përshëndes dhe vlerësoj profesionalizmin dhe punën e palo-



dhur të çdo efektivit ushtarak e civil, veçanërisht ish-komandantët që kanë shërbyer përgjatë këtyre viteve në këtë njësi! Por njëkohësisht më bën krenar për të qenë në lartësinë e përgjegjshmërisë të detyrës, krahas të gjithë efektivëve ushtarakë dhe civilë të kësaj strukture që unë drejtoj, e cila është një strukturë po aq e rëndësishme sa edhe e veçantë në llojin e vet. Por që sigurisht ka vështirësitë dhe sfidat e veta.

Sot, Policia Ushtarake është një strukturë e specializuar për veprime policore në përbërje të FA-së, që e ushtron juridiksionin e saj në territorin e RSH si dhe jashtë vendit kur dërgohet me mision, shërbim, stërvitje ose në mbështetje të FA-së.

**Në këtë përvjetor, mund të na thoni diçka më tepër rreth krijimit të Policisë Ushtarake? Pse lindi nevoja për të pasur një Polici Ushtarake brenda strukturës së FARSH-së?**

Policia Ushtarake u krijua, më 1 shkurt 1992, pas rrjedhës së tranzicionit dhe fillimit të ndryshimeve të viteve '90, gjë që solli një sërë transformimesh dhe ndryshimesh të mëdha në të gjithë strukturat e Forcave të Armatosura. Ajo lindi si nevojë e ndryshimeve të kohës, duke kaluar nga një forcë tipike ushtarake, në një strukturë ligj-zbatuese ushtarake me detyra policore.

Policia Ushtarake, u krijua me ndihmën dhe asistencën e vendeve aleate që sollën modelin e të qenit e një strukture ushtarake policore në Shqipëri, u zhi-

luan trajnimet fillestare nga Arma e Karabinierisë Italiane, e cila ishte ndër strukturat e para të NATO-s, që e pajisi këtë strukturë të re me teknikë dhe armatim modern për kohën, ku me kalimin e viteve vijoi bashkëpunimi edhe me vende të tjera partnere si Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Turqia për aftësimin profesional të kësaj strukture të re.

Ka qenë pikërisht ky bashkëpunim që e shndërroi Policinë Ushtarake në një strukturë të konsoliduar për

ruajtjen e rendit ushtarak, mbrojtjen e personelit dhe garantimin e zbatimit të ligjit nga veprimtaritë e kundërligjshme në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si dhe përfaqësimin e saj sa më dinjitoz në misionet ushtarake ndërkombëtare, e institucionalizuar me miratimin në Parlament të ligjit nr. 7511, datë 08.08.1991, "Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë".

Fillimisht, struktura e re e krijuar

ishite një strukturë e vogël në personel, mjete dhe detyra. Këtu dua të përmend krijimin e dy organeve të Policisë Ushtarake për atë kohë si Sektori i Disiplinës Ushtarake dhe Sektori i Qarkullimit Rrugor. Me kalimin e viteve, në përshtatje me zhvillimet e Forcave të Armatosura, mjedisin e ri të sigurisë, struktura dhe organizimi i Policisë Ushtarake ka ndryshuar në vazhdimësi, duke u ngritur profesionalisht, duke rritur e zhvilluar kapacitetet operacionale sipas treguesve operacionalë në interes të realizimit të detyrave dhe misionit të saj kushtetues.

**Ju përmendët misionin kushtetues, cili është ai, pak më gjerësisht? Si ka evoluar ndër vite dhe a kanë ndryshuar detyrat e Policisë Ushtarake, që nga krijimi i saj si një strukturë brenda Forcave të Armatosura?**

Misioni i Policisë Ushtarake vazhdon të jetë që nga gjeneza e saj, ruajtja e rendit ushtarak, garantimi i zbatimit të ligjit nga veprimtaritë e kundërligjshme në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, mbrojtja e jetës së personelit, mbështetja për mbrojtjen e pronës shtetërore në administrim dhe përdorim të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura, angazhimi në luftën kundër terrorizmit dhe pjesëmarrja në operacionet paqeruajtëse e humanitare.

Detyrat e Policisë ushtarake rrje-dhin nga misioni i saj dhe unë mund të përmend disa nga detyrat kryesore të Policisë Ushtarake që ajo kryen në kohë paqeje, në situatë krizash dhe jo vetëm, siç janë:



Ndërhyrja (me kërkesë të komandave dhe të drejtuesve të institucioneve ushtarake) në repartet ushtarake për parandalimin dhe mënjanimin e veprimeve të kundërligjshme që kanë të bëjnë me prishjen e rendit ushtarak; Hetimi i veprave penale të kryera në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me organet ligj zbatuese në vend; Ndërhyrja për të ndërprerë aktet e terrorizmit në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë; Ndërhyrja përkrah Policisë së Shtetit për të rivendosur rendin në rast të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, të krijuar si rezultat i kryerjes së veprave me qëllime terroriste dhe krimeve kundër autoritetit të shtetit; Realizimi me urdhër të autoritetit epror, të lirim të pronave në administrim ose përdorim të Ministrisë së Mbrojtjes të zëna forcërisht nga palë të treta; Kryerja e detyrave policore në interes të ushtarakëve shqiptarë që kryejnë misione jashtë vendit, si dhe forcave ushtarake të huaja që vepron në territorin shqiptar, në përputhje me legjislacionin në fuqi; Kryerja e funksioneve të Policisë Ushtarake në operacionet ushtarake dhe paqeruajtëse jashtë vendit, në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara; Shoqërimi dhe sigurimi i Personaliteteve të Larta ushtarake të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, delegacionet e huaja ushtarake të njësuara me to, si dhe forcat e huaja ushtarake që kalojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë; Mbajtja nën kontroll e rrjetit rrugor në zonat e operacioneve dhe dhënie e masave administrative sipas Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, për drejtuesit e mjeteve ushtarake që shkelin rregullat e qarkullimit rrugor; Kontrollimi dhe marrja e masave për zbatimin e legjislacionit në fuqi për Mbrojtjen nga Zjarri; Mbështetja e kryerjes së operacioneve ku angazhohen Forcat e Armatosura, brenda dhe jashtë vendit; Dhe së fundmi në gjendje lufte, Policia Ushtarake kryen sigurimin e personelit, të materialeve dhe mjeteve luftarake, merr masa për grumbullimin, evakuimin, ruajtjen dhe sigurimin e robërve të luftës, si dhe të personelit civil të ndaluar.

**Si e realizoni ju këtë mision? Sa të pranishëm jeni në aktivitetin e përditshëm të Forcave të Armatosura?**

Policia Ushtarake është e pranishme 24 orë në 7 ditë, si pjesë e veprimtarisë që kryejnë Forcat e Armatosura të RSH. Misioni i Policisë Ushtarake realizohet në zbatim të detyrave të përcaktuara në ligjin për Policinë Ushtarake dhe në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e tjera të sigurisë në vend e bazuar kjo në marrëveshjet e hartuara mes institucioneve.

**Duke u kthyer tek detyrat dhe misioni juaj, si është e organizuar Policia Ushtarake e FA-së? Si funksionon struktura juaj, diçka rreth sektorëve të punës tuaj, apo inspektorateve që përmendët më lart?**

Policia Ushtarake e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë është e organizuar në bazë reparti, nënreparti sektori, inspektorati, shërbimi, seksioni, strukturë e specializuar për veprime policore në përbërje të FA-së në vartësi të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Bazuar në misionin e PU-së,



Policia Ushtarake funksionon sipas një linje komandim-drejtimi shtabi, nënrepartet operacionale, seksioni i rendit ushtarak, policia kriminale, Inspektorati i qarkullimit rrugor dhe Inspektorati i MNZSH, të cilat kryejnë detyrat dhe kanë përgjegjësitë e tyre të sanksionuara në Ligjin për Policinë Ushtarake në FA dhe aktet ligjore e n/ligjore sipas fushave përkatëse (për parandalimin e ndjekjen e veprimtarisë kriminale, rendi ushtarak, qarkullimi rrugor, mbrojtja nga zjarri e shpëtimi etj.).

**Diçka rreth përfaqësimit tuaj në FA, dallimit siç është uniforma juaj për shembull. Cilat janë ngjyrat dhe shenjat dalluese që ju veçojnë, apo ato të mjeteve lëvizëse të Policisë Ushtarake të Forcave të Armatosura?**

Ngjyra që uniforma e Policisë Ushtarake mbart është diçka që na lidh me shumicën e homologëve të vendeve partnere, sepse tregon dallimin dhe veçantinë e saj nga radhët e Forcave të Armatosura. Ngjyra blu dhe e zezë na afrojnë me faktin e të qenit një forcë policore, por armatimi dhe mjetet që ne mbartim nënvizojnë identitetin ushtarak që na simbolizon.

**Përmendët armatimin dhe mjetet, sa e pajisur është Policia Ushtarake e FA-së? Sa bashkëkohore është ajo?**

Për të përmbushur me sukses detyrat e ngarkuara dhe për të ruajtur gatishmërinë në nivele të larta, është bërë i mundur modernizimi dhe kompletimi i Policisë Ushtarake me teknike dhe mjete të kalueshmërisë së lartë e të blinduar.

Ndërkohë me projektet e modernizimit, Policia Ushtarake ka në përdorim mjete te lehta taktike 4x4 të tipit "Land Rover", mjete shoqërimi 2x4 të tipi "Fiat Egea", si dhe mjete transportuese të blinduara niveli 3-4 të tipi "Iveco LINCE". Por nga ana tjetër kompletimi me mjete të reja ka rritur kapacitetin operacionale, për kryerjen e detyrave të vështira në zona me rrezikshmëri të lartë e më gjerë. Gjithashtu, një ndër projektet e modernizimit të teknikës, që ka filluar në vitin 2012, është edhe kompletimi me pajisje operacionale dhe kompletimi me armatim të ri i efektivave që kryejnë detyra operacionale.

**Ju përmendët se një nga detyrat tuaja është edhe kryerja e funksioneve të Policisë Ushtarake në operacionet ushtarake dhe paqeruajtëse jashtë vendit. Si përfshihet**

**PU-ja më konkretisht, sa ka qenë pjesëmarrja në këto operacione paqeruajtëse e humanitare?**

Policia Ushtarake kryen operacione stabiliteti (në kuadër të "Stability Policing") mbas vendosjes së paqes, ku ndihmon në ngritjen e kapaciteteve të policisë lokale/vendase, duke bërë trajnimin e tyre me anë të asistencës dhe bashkëveprimin në terren. Gjithashtu Policia Ushtarake merr pjesë në misione paqeruajtëse si pjesë policore brenda kontingjentëve të Forcave të Armatosura.

Deri më tani, Policia Ushtarake ka kryer misione të ndryshme jashtë vendit në Irak, Chad, Bosnjë-Hercegovinë, Afganistan, Detin Egje dhe Kosovë, dhe ka kontribuar në emergjenca civile, duke marrë pjesë direkt ose në mbështetje të strukturave të FA-së. Policia ushtarake është e përgatitur për të vepruar në të gjithë spektrin e misionit dhe detyrave.

**Po në luftën kundër terrorizmit sa të angazhuar jeni, a keni ju kapacitetet e nevojshme?**

Po sigurisht, ne jemi shumë të angazhuar në luftën kundër terrorizmit, që është një nga fushat tepër të rëndësishme të detyrave tona, që ne kemi ndër prioritetet tona si detyrat e tjera që ndjekim. Dhe Policia Ushtarake sigurisht që ka kapacitete njerëzore dhe teknike për angazhimin në luftën kundër terrorizmit në bashkëpunim tepër të ngushtë me institucionet e tjera të sigurisë brenda dhe jashtë vendit. Ju sjell në vëmendje se në kuadër të Strategjisë Kombëtare kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit janë planëzuar masa dhe jemi në përmirësim të vazhdueshëm për sa i përket forcimit të kapaciteteve njerëzore dhe teknikës në luftën kundër terrorizmit për të bërë të mundur parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen e veprimtarisë kriminale ose të veprimtarive terroriste brenda strukturave të FA-së dhe jashtë saj në bashkëpunim me Policinë e Shtetit.

**Po raste të veprimeve të kundërligjshme në FA, a ka pasur? Sa ka qenë Policia Ushtarake pjesë e luftës kundër korrupsionit?**

Policia Ushtarake ka struktura të specializuara që janë të angazhuar në luftën kundër korrupsionit.

Unë mund t'ju them se raste të veprimeve të paligjshme ka pasur dhe sigurisht ato janë trajtuar nga strukturat e specializuara, duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore në bashkëpunim me agjencitë e tjera ligj zbat-

uese duke grumbulluar informacion, hetuar dhe referuar në prokurori për çdo rast kur është vërtetuar një kryerje e një veprave penale.

**Kur themi se bashkëvepron Policia Ushtarake me Policinë e Shtetit, si ta kuptojmë? A keni pasur ju raste të ndonjë bashkëpunimi?**

Ligji i Policisë Ushtarake përmban angazhimin e strukturave të saj në mbështetje të policisë së shtetit, që citohet qartë në detyrat dhe misionin e saj. (Ndërhyn përkrah Policisë së Shtetit për të rivendosur rendin në rast të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, të krijuar si rezultat i kryerjes së veprave me qëllime terroriste dhe krimeve kundër autoritetit të shtetit). Rast për t'u përmendur ishte rasti i angazhimit të luftës ndaj Covid-19, ku struktura jonë ishte në këmbë përkrah institucioneve të tjera ushtarake, që për hir të së vërtetës bënë diferencën në përballimin me sukses të situatës, ashtu si FA-të në tërësi. Por unë dua të përmend gjithashtu që strukturat ligj zbatuese të Policisë Ushtarake vazhdimisht janë në bashkëpunim të pa ndërprerë me Policinë e Shtetit.

Gjithashtu, kemi marrëveshje me Policinë e Shtetit dhe jemi në bashkëpunim të vazhdueshëm për mbrojtjen dhe ndërhyrjet e paligjshme në pasurinë që është në administrim dhe përdorim të Ministrisë së Mbrojtjes dhe strukturave të Forcave të Armatosura.

**Sa e përhapur është Policia Ushtarake në rrethet e tjera të vendit, sa ndjehet puna e saj? Si e ushtroni ju detyrën tuaj në këto rrethet?**

Po sigurisht puna jonë ndjehet edhe në rrethet e tjera. Policia Ushtarake është e përhapur aty ku ka edhe dislokime të Forcave të Armatosura, dhe është e organizuar me Seksione (SPU) në qytetet (Shkodër, Kukës, Burrel, Durrës, Elbasan, Korçë, Berat, Vlorë dhe Gjirokastrë), të cilat kryejnë të gjitha detyrat, e bazuar kjo në listë-detyrat themelore që rrjedhin nga misioni i Policisë Ushtarake, të cilat i përmenda më lart.

**Ku shkollohen efektivët tuaj? Sa të trajnuar janë ata? A bashkëpunoni ju me homologët e vendeve të tjera dhe ku konsiston ky bashkëpunim?**

Polica Ushtarake për të përditësuar kapacitetet operacionale dhe akademike mban kontakt të vazhdueshëm me homologët e saj, siç është Arma e Karabinierisë Italiane, Xhandarmëria Turke, Policia e FSK-së dhe bashkë-

punëtorë të tjerë rajonalë si: Greqia, Mali i Zi dhe Maqedonia.

Fokusi i Policisë Ushtarake është dhe do të vazhdojë të jetë azhurnimi dhe përditësimi i saj në mënyrë të vazhdueshëm, për të qenë sa më afër zhvillimeve dhe risive të politikave të NATO-s në kuadër të "Military Police".

Bashkëpunimi me homologët konsiston dhe fillon që tek shkollimi i efektivit të Policisë Ushtarake duke patur mundësinë e studimit në akademitë ushtarake të vendeve partnere, në trajnimin e vazhdueshëm nga ana e tyre për sa i përket përvetësimit të detyrave dhe misionit të Policisë Ushtarake, siç janë trajnimi në kuadër të shpërndarjes së turmave, shoqërimi i Personaliteteve të Larta Ushtarake, taktikat dhe mënyra e ndërhyrjes në banesë dhe lirimi i pronës shtetërore ushtarake të zaptuar nga të tretë, drejtimi i mjeteve të blinduara në misionet brenda dhe jashtë vendit, ku Policia Ushtarake merr pjesë, përvetësimi i aftësive policore në qitjet operative etj.

**Cilat janë objektivat e trajnimeve, sa efektive janë ato të efektivëve tuaj?**

Patjetër që trajnimet që merr personeli ynë është efektiv dhe gjithashtu kemi objektivat tona në këto trajnime, me qëllim që të kemi një personel të gatshëm dhe të mirë stërvitur për çdo situatë. Çdo trajnim ku merr pjesë Policia Ushtarake luan rol në aftësimin e saj dhe është në kuadër të zbatimit të misionit dhe detyrave që kemi ne si strukturë. Pra objektivat kryesore mbeten dhe do të jenë aftësimi i efektivave të rinj që rekrutohen dhe shërbejnë në Policinë Ushtarake si dhe rritja e nivelit operacionale dhe zhvillimi i kapaciteteve operacionale në të gjithë treguesit e saj.

**Çfarë standardesh keni arritur ju sot që po flasim, si batalion i Policisë Ushtarake dhe çfarë objektivash keni për të ardhmen?**

Për t'ju përgjigjur me një paralelizim të thjeshtë, më lejoni t'ju them se Policia Ushtarake e ditëve të sotme është jo vetëm më shumë e zhvilluar dhe kompletuar, por ka arritur nivele operacionale, akademike dhe nivele specializimi në fushën e zbatimit të ligjit në nivele të barabarta dhe bashkëkohore me vendet aleate të NATO-s dhe ato rajonale. Sot, Policia Ushtarake është një strukturë e kompletuar me bazën ligjore dhe dokumentare të nevojshme, e cila udhëhiqet nga Plani Afatgjatë 2022 - 2031 i zhvillimit të PU-së, ku janë përcaktuar objektivat e zhvillimit sipas periudhave afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë.

Në zbatim të detyrimeve të vizionit të shefit të SHPPFA për vitet 2022 - 2025, projekteve të modernizimit të miratuara si dhe planeve të bashkëpunimit që kemi me strukturat e tjera të sigurisë. Objektivat kryesore të së ardhmes do të jenë: Zhvillimi i kurseve funksionale dhe institucionale në PU dhe me homologët brenda dhe jashtë vendit, në interes të rritjes së profesionalizimit të efektivave; Kompletimi me armatim sipas standardeve të NATO-s dhe me automjete taktike të kalueshmërisë së lartë, në zbatim kjo të programeve të modernizimit për PU-në në kuadër të FA-së; Sigurimi i kapaciteteve të plota akomoduese dhe magazinuese për krijimin e kushteve sa më të mira në interes të zhvillimit të stërvitjeve dhe aftësimi të trupës operacionale.





# Marrëveshja e Gjellbër Evropiane

## Objektivi i 2030 me zero emisione për autobusët e rinj të qytetit dhe 90% reduktime të emetimeve për kamionët e rinj deri në vitin 2040

**K**omisioni Evropian ka propozuar objektiva të reja ambicioze të emetimeve të CO2 për automjetet e reja të rënda (HDV) nga viti 2030 e tutje. Këto objektiva do të ndihmojnë në reduktimin e emetimeve të CO2 në sektorin e transportit - kamionët, autobusët e qytetit dhe autobusët në distanca të gjata janë përgjegjës për mbi 6% të emetimeve totale të gazit serrë të BE-së (GHG) dhe më shumë se 25% të emetimeve të GHG nga transporti rrugor. Këto standarde të përforuara të emetimeve do të siguronin që ky segment i sektorit të transportit rrugor të kontribuojë në zhvendosjen drejt lëvizshmërisë me emetime zero dhe objektivat e klimës dhe ndotjes zero të BE-së.

Komisioni propozon hapjen e standardeve më të forta të emetimeve të CO2 për pothuajse të gjitha HDV-të e reja me emetime të certifikuar të CO2, krahasuar me nivelet e vitit 2019, veçanërisht:

- 45% ulje të emetimeve nga viti 2030;
- 65% reduktime të emetimeve nga viti 2035;
- Ulje 90% e emetimeve nga viti 2040.

Për të stimuluar vendosjen më të shpejtë të autobusëve me emetim zero në qytete, Komisioni propozon gjithashtu që të gjithë autobusët e rinj të qytetit të jenë pa emetim zero që nga viti 2030.

Në përputhje me objektivat e Marrëveshjes së Gjellbër Evropiane dhe REPowerEU, ky propozim do të ketë gjithashtu një ndikim pozitiv në tranzicionin e energjisë, duke ulur kërkesën për lëndë djegëse fosile të importuara dhe duke rritur kursimet e energjisë dhe efikasitetin në sektorin e transportit të BE-së. Ai do të ofrojë përfitime për operatorët evropianë të transportit dhe përdoruesit duke reduktuar kostot e karburantit dhe koston totale të pronësisë, dhe do të sigurojë një vendosje më të gjerë të automjeteve më efikase në energji. Ai do të përmirësojë gjithashtu cilësinë e ajrit, veçanërisht në qytete, dhe shëndetin e evropianëve.

Për më tepër, ky është një sektor kyç për të mbështetur industrinë evropiane të teknologjisë së pastër dhe për



të rritur konkurrencën ndërkombëtare. BE-ja është një lider tregu në prodhimin e kamionëve dhe autobusëve dhe një kuadër i përbashkët ligjor ndihmon për të siguruar këtë pozicion për të ardhmen. Në veçanti, standardet e rishikuara ofrojnë një sinjal të qartë dhe afatgjatë për të udhëhequr investimet e industrisë së BE-së në teknologjitë inovative me emitim zero dhe për të nxitur shtrirjen e infrastrukturës së rimbushjes dhe karburantit.

Emetimet në sektorin HDV janë rritur nga viti në vit që nga viti 2014 me përjashtim të vitit 2020 për shkak të pandemisë COVID-19. Veçanërisht në sektorin e mallrave, emetimet po rriten me shpejtësi. Kjo është kryesisht për shkak të rritjes së kërkesës për transport rrugor, e cila pritet të vazhdojë të rritet në të ardhmen. Në vitin 2019, emetimet e mallrave ishin 44% më të larta se emetimet nga sektori i aviacionit dhe 37% më të larta se emetimet e transportit detar.

Shumica dërrmuese e automjeteve të rënda në flotën e BE-së

(99%) aktualisht funksionojnë me motorë me djegie të brendshme, të ushqyer kryesisht nga karburantet fosile të importuara si dizel. Kjo shton varësinë energjetike të BE-së dhe paqëndrueshmërinë aktuale të tregut të energjisë.

Standardet aktuale të emetimeve të HDV datojnë nga viti 2019, por nuk janë më në përputhje me objektivat klimatike të BE-së. Legjislacioni ekzistues nuk jep një sinjal mjaftueshëm të qartë dhe afatgjatë për investitorët dhe nuk pasqyron realitetin e ri në sektorin e energjisë dhe zhvillimit e shpejta në industrinë e HDV në nivel global. Standardet e reja të propozuara të CO2 janë në përputhje me ambiciet e rritura të klimës së BE-së, paketën Fit for 55 dhe Marrëveshjen e Parisit.

Për të mbështetur këtë propozim, investimet duhet të kanalizohen në automjetet me emitim zero dhe në infrastrukturën e rimbushjes dhe karburantit, dhe Komisioni tashmë ka propozuar Rregulloren e Infrastrukturës së Karburanteve Alternative për të zhvilluar infrastrukturën e nevo-

jshme të tarifimit për të mbështetur tranzicionin e gjellbër të automjeteve të rënda. Në veçanti, Komisioni propozoi instalimin e pikave të karikimit dhe karburantit në intervale të rregullta në autostradat kryesore: çdo 60 kilometra për karikim elektrik dhe çdo 150 kilometra për karburant me hidrogjen. Komisioni po punon intensivisht me bashkë-ligjvënësit për të finalizuar negociatat për këto propozime.

*"Për të arritur objektivat tona për klimën dhe zero ndotje, të gjitha pjesët e sektorit të transportit duhet të kontribuojnë në mënyrë aktive. Në vitin 2050, pothuajse të gjitha automjetet në rrugët tona duhet të kenë emetim zero. Ligji ynë i klimës e kërkon atë, qytetet tona e kërkojnë atë dhe prodhuesit tanë po përgatiten për të. Me propozimin e sotëm, ne po sigurohemi që kamionët e rinj po bëhen më pak ndotës dhe që më shumë autobusë me emitim zero do të kalojnë nëpër qytetet tona. Luftimi i krizës klimatike, rritja e cilësisë së jetës së qytetarëve tanë dhe rritja e konkurrencës industriale të Evropës shkojnë dorë për dorë", Frans Timmermans, Zëvendës President Ekzekutiv për Marrëveshjen e Gjellbër Evropiane.*

### Fit for 55: Zero emetime CO2 për makinat dhe furgonët e rinj në 2035

- Transporti rrugor për të kontribuar më shumë në objektivin e BE-së për neutralitetin e klimës
- Metodologji e re për vlerësimin e emetimeve të CO2 gjatë gjithë ciklit të jetës së një automjeti
- Përaftrimi i vlerave kufi të emetimeve me emetimet e botës reale

Parlamenti miratoi objektivat e reja të reduktimit të emitimeve të CO2 për makinat e reja të pasagjerëve dhe automjetet e lehta komerciale, pjesë e paketës "Fit for 55".

Me 340 vota pro, 279 kundër dhe 21 abstenime, eurodeputetët miratuan

marrëveshjen e arritur me Këshillin mbi standardet e rishikuara të performancës së emimit të CO2 për makinat dhe furgonët e rinj në përputhje me ambiciet e rritura të BE-së për klimën.

Legjislacioni i ri përcakton rrugën drejt emitimeve zero të CO2 për makinat e reja të pasagjerëve dhe automjetet e lehta komerciale në 2035 (një objektivi i gjerë i flotës së BE-së për të reduktuar emetimet e CO2 të prodhuara nga makinat dhe furgonët e rinj me 100% krahasuar me 2021). Objektivat e ndërmjetëm të reduktimit të emitimeve për vitin 2030 janë vendosur në 55% për makinat dhe 50% për furgonët.

### Masat e tjera kryesore të parashikuara me rregullore:

Komisioni do të prezantojë deri në vitin 2025 një metodologji për të vlerësuar dhe raportuar të dhënat mbi emetimet e CO2 gjatë gjithë ciklit të jetës së makinave dhe furgonëve të shitur në tregun e BE-së, të shoqëruar me propozime legjislative aty ku është e përshtatshme.

Deri në dhjetor 2026, Komisioni do të monitorojë hendekun midis vlerave kufitare të emitimeve dhe të dhënave reale të konsumit të karburantit dhe energjisë, do të raportojë mbi një metodologji për rregullimin e emetimeve specifike të CO2 të prodhuesve dhe do të propozojë masat e duhura përcjellëse. Mekanizmi aktual nxitës i automjeteve me emitim zero dhe të ulët (ZLEV), i cili shpërblen prodhuesit që shesin më shumë automjete të tilla (me emitime nga zero në 50 g CO2/km, si automjetet elektrike dhe hibridet plug-in me performancë të mirë) me CO2 më të ulët objektivat e reduktimit të emitimeve, do të përshtaten për të përmbushur tendencat e pritshme të shitjeve. Nga viti 2025 deri në vitin 2029, standardi i ZLEV është vendosur në 25% për shitjet e makinave të reja dhe 17% për furgonët e rinj, dhe nga viti 2030 stimulimi do të hiqet.

## Parashikimi ekonomik i dimrit 2023: Ekonomia e BE-së do të shmangë recesionin, por erërat e kundërta vazhdojnë

Pothuajse një vit pasi Rusia nisi luftën e saj të agresionit kundër Ukrainës, ekonomia e BE-së hyri në vitin 2023 me një bazë më të mirë se sa ishte parashikuar në vjeshtë. Parashikimi i ndërmjetëm i dimrit e rrit perspektivën e rritjes për këtë vit në 0.8% në BE dhe 0.9% në zonën e euros. Të dyja fushat tani janë të vendosura për të shmangur ngushtësisht recesionin teknik që ishte parashikuar në fund të vitit. Parashikimi gjithashtu ul pak projeksionet për inflacionin si për vitin 2023 ashtu edhe për vitin 2024.

### Parashikimi përmirësohet falë qëndrueshmërisë së shtuar

Pas zgjerimit të fuqishëm në gjysmën e parë të 2022, momenti i rritjes u zvogëlua në tremujorin e tretë, megjithëse pak më pak se sa pritej.

Zhvillimet e favorshme që nga parashikimi i vjeshtës kanë përmirësuar perspektivën e rritjes për këtë vit. Diversifikimi i vazhdueshëm i burimeve të furnizimit dhe një rënie e mprehtë e konsumit i kanë lënë nivelet e ruajtjes së gazit mbi mesataren sezonale të viteve të kaluara dhe çmimet



me shumicë të gazit kanë rënë shumë nën nivelet e paralufës. Përveç kësaj, tregu i punës i BE-së ka vazhduar të performojë fuqishëm, me normën e papunësisë që ka mbetur në nivelin më të ulët historik prej 6.1% deri në fund të 2022. Besimi po përmirësohet dhe anketat e janarit sugjerojnë se aktiviteti

ekonomik është vendosur gjithashtu për të shmangur një tkurrje në tremujorin e parë të vitit 2023.

Megjithatë, erërat e kundërta mbeten të forta. Konsumatorët dhe bizneset vazhdojnë të përballesh me kosto të larta të energjisë dhe inflacionin bazë (inflacioni total pa

energjinë dhe ushqimet e papërpunuar) ishte ende në rritje në janar, duke gërryer më tej fuqinë blerëse të familjeve. Ndërsa presionet inflacioniste vazhdojnë, shtrëngimi monetar pritet të vazhdojë, duke rënduar aktivitetin e biznesit dhe duke ushtruar një zvarritje të investimeve.

### Pas kulmit në vitin 2022, inflacioni do të lehtësohet gjatë horizontit të parashikimit

Tre muaj radhazi të zbutjes së inflacionit total sugjerojnë se kulmi është tashmë pas nesh, siç parashikohet në parashikimin e vjeshtës. Pas arritjes së një niveli më të lartë historik prej 10.6% në tetor, inflacioni është ulur, me vlerësimin e shpejtë të janarit në 8.5% në zonën e euros. Rënia është nxitur kryesisht nga rënia e inflacionit të energjisë, ndërkohë që inflacioni bazë nuk ka arritur ende kulmin.

Parashikimi i inflacionit është rishikuar lehtësisht në rënie krahasuar me vjeshtën, duke reflektuar kryesisht zhvillimet në tregun e energjisë. Inflacioni total parashikohet të bjerë nga 9.2% në 2022 në 6.4% në 2023 dhe në 2.8% në 2024 në BE. Në zonën e euros, parashikohet të ngadalësohet nga 8.4% në 2022 në

5.6% në 2023 dhe në 2.5% në 2024. Rreziqet ndaj perspektivës janë më të balancuara

Ndërsa pasiguria rreth parashikimit mbetet e lartë, rreziqet ndaj rritjes janë gjerësisht të balancuara. Kërkesa e brendshme mund të dalë më e lartë se sa ishte parashikuar nëse rënia e fundit e çmimeve të gazit me shumicë kalon në çmimet e konsumit më fuqishëm dhe konsumi rezultim më elastik. Megjithatë, një ndryshim i mundshëm i kësaj rënieje nuk mund të përjashtohet në kontekstin e tensioneve të vazhdueshme gjeopolitike. Kërkesa e jashtme gjithashtu mund të rezultojë të jetë më e fortë pas rihapjes së Kinës - e cila megjithatë mund të nxisë inflacionin global.

Rreziqet ndaj inflacionit mbeten të lidhura kryesisht me zhvillimet në tregjet e energjisë, duke pasqyruar disa nga rreziqet e identifikuar për rritjen. Veçanërisht në vitin 2024, mbizotërojnë rreziqet e larta për inflacionin, pasi presionet e çmimeve mund të rezultojnë më të gjera dhe më të rrënjosura se sa pritej, nëse rritja e pagave do të vendosej me ritme mbi mesataren për një periudhë të qëndrueshme.



ANJEZA MUSOLLARI,  
Shefe e Sektorit të Botimeve

# "Nëse të pyesin për Turqinë, thuaju: Ata që shpëtuan vdiqën, e ata që vdiqën shpëtuan!"

*"Rëndohet bilanci, mbi 41 mijë të vdekur nga tërmeti në Turqi dhe Siri. Zvogëlohen shpresat për të mbijetuar"*

**N**jë tërmet i fuqishëm ka goditur një zonë të gjerë në Turqinë juglindore, pranë kufirit me Sirinë, duke vrarë mbi 41 mijë njerëz dhe duke lënë nën rrënoja me qindra persona të tjerë. Lëkundjet fatale zgjatën rreth një minutë dhe u ndjenë deri në Qipro, Egjipt dhe Liban.

Tituj lajmesh të një realiteti të dhimbshëm, të tmerrshëm, nga ata që e tejkalojnë imagjinatën shpesh të shfrenuar të njeriut.

Por ndodhi, toka s'po gjen qetësi. Ajo 'përçapet' lart e poshtë si të dojë të hakmerret ndaj nesh. "Urrejtje legjitime besoj!" E gërryem, ia premë lidhjet e saj 'dashurore' me natyrën, pemët, rrënjët e të cilave e mbushnin me oksigjen. Dhe ja tek u hakmor, teksa brenda saj mori me mijëra jetë njerëzish të pafajshëm, foshnjash, sytë e të cilëve ende ishin përgjumësh.

Fatkeqësitë natyrore shpesh na kujtojnë se sa të kujdesshëm duhet të tregohemi me çdo fenomen që ndodh pas vënies dorë të njeriut mbi gjithçka prish balancat të cilat vetë natyra ka vendosur me 'ligjet e saj'.

Katastrofa natyrore e ndodhur pak ditë më parë tronditi jo vetëm Turqinë dhe Sirinë por gjithë botën, solli në vëmendjen e gjithsecilit kuptimin e jetës.


Shumicën e kohës ne thjesht bezdisemi nga moti, një fluturim aeroplani i vonuar, një piknik i anuluar, ose diçka tjetër e këtij lloji. Herë pas here disa njerëz diku preken në mënyrë drastike nga moti ose nga forcat më të dhunshme të natyrës. Një thatësirë e zgjatur than të mbjellat e fermerit, një stuhi breshëri i shkatërron ato brenda një ore. Një tornado në Teksas lë me qindra pa strehë, dhe një tajfun në Bangladesh shkatërron me mijëra hektarë të mbjellash.

Kurdoherë që ndikohemi nga moti, nëse është një bezdisje apo një fatkeqësi madhore, ne priremi ta shohim atë si asgjë më shumë sesa shprehja e ftohtë e disa ligjeve të caktuara meteorologjike dhe gjeologjike.

Forcat në tokë vazhdimisht përkuilin koren e saj, derisa vjen një ditë që kërcet, duke shkaktuar një tërmet madhor. Qoftë i vogël apo traumatik, ne priremi të mendojmë për shprehjet e natyrës si "thjesht ndodhi" dhe veten tonë si viktimat "e pafat" të asaj që natyra sjell. Si specie, një person ka nevojë për një përbërje dhe presion të caktuar të ajrit atmosferik, ujë të pastër natyror me kripëra të tretura në të, bimë dhe kafshë dhe temperaturë tokësore. Mjedisi optimal për njerëzit është ajo gjendje natyrore e natyrës, e cila ruhet nga proceset normale të qarkullimit të substancave dhe rrjedhave të energjisë. Si specie biologjike, një person me aktivitetin e tij jetësor ndikon në mjedisin natyror jo më shumë se organizmat e



"Shpëtohet pas 68 orësh një foshnje nga rrënojat në Turqi"



"Një engjëll me zemër të madhe, 9-vjeçari dhuron kursimet e tij për të prekurit e tërmetit në Turqi"

tjerë të gjallë. Megjithatë, ky ndikim është i pakrahasueshëm me ndikimin e madh që ka njerëzimi në natyrë përmes punës së tij. Ndikimi transformues i shoqërisë njerëzore në natyrë është i pashmangshëm, ai intensifikohet me zhvillimin e shoqërisë, rritet numri dhe masa e substancave të përfshira në qarkullimin ekonomik. Ndryshimet e bëra nga njeriu tani kanë marrë një shkallë kaq të madhe, saqë janë shndërruar në një kërcënim për prishjen e ekuilibrit që ekziston në natyrë dhe në një pengesë për zhvillimin e mëtejshëm të forcave prodhuese. Për një kohë të gjatë, njerëzit e shikonin natyrën si një burim të pashtershëm të të mirave materiale që u nevojiteshin. Megjithatë, të përballur me pasojat negative të ndikimit të tyre në natyrë, ata gradualisht arritën të besonin në nevojën e përdorimit dhe mbrojtjes racionale të saj.

Përballja me fenomenet e shkatërrimit, të cilat shpesh duken si një regji filmi dhe ne aktorët e mjerë të saj, me trupa të pajetë në duar... Pa diskutim i nominuar për "Oskar".

## Kur nga vdekja lind jeta

Ndërkohë që nuk kanë fund lajmet e hidhura që vijnë nga Turqia dhe Siria me rritjen e bilancit të viktimitave dhe të plagosurve si pasojë e tërmetit shkatërrimtar, ka edhe lajme të cilat sjellin shpresë, ku jeta ia del të lindë edhe në kushtet më të vështira.

Ngjarja e pazakontë raportohet të ketë ndodhur në Siri, ku një bebe ka

lindur mes rrënojave të tërmetit në Aleppo, ndërsa nëna fatkeqësisht ka humbur jetën nga lindja e vështirë nën mbetjet e ndërtesave të rrëzuara. I dha jetën, për t'u larguar dhimbshëm nga jeta e saj.

Të dridhura, të qara, vajtime, pluhur, banesa të shkatërruara ose më keq, të gllabëruara nga toka në zemër të saj, fëmijë të frikësuar, ekipe të kërkim-shpëtimit, ambulanca, mjekë dhe forca të shumta policie e ushtrie. Kjo është panorama që na ofrohet nga katastrofa të tilla.

Tragjeditë sprovajnë njerëzit, popujt,

është tejet i ashpër.

Njerëz që ecin gjysmë të ngrirë rrugës, ose mbyllen në makina. Janë tejet të frikësuar, nuk e dinë se çfarë do të ndodhë, sepse ndoshta tërmeti nuk ka mbaruar akoma e thuhet se mund të vijnë lëkundje të reja, të forta dhe shkatërrimtare.

Qindra viktimat të tjera tashmë po numërohen në zonat siriane, jashtë kontrollit të qeverisë së Damaskut. Tërmeti nuk kurseu asgjë.

Gazeta turke hapet me titullin e parë greqisht: "Faleminderit shumë!"



EFHARISTO POLI FILE  
TEŞEKKÜRLER KOMŞU

shtetet, duke krijuar humbje, plagë, dhimbje. Lajme të tëra janë rrafshuar.

Mijëra njerëz kanë mbetur të pastrehë tani në dimër, kur temperaturat janë nën zero gradë.

Qyteti, që pak ditë më parë gëllonte zërash jete, sot gjendet nën rrënojat e ndërtesave, pa energji elektrike, pa ujë e pa ngrohje. Bën shumë ftohtë e dimri

Ndasitë politike, apo orekset territoriale, të cilat shpesh krijojnë konflikte në situata të tilla nuk kanë vlerë. Humanizmi, virtyti i humanëve, është prioritet, dhe kjo na bën të besojmë se e ardhmja do jetë e paqte për sa kohë njerëzimi do dijë të bashkëjetojë me natyrën dhe llojin e tij.



# U SHEKULLOFSH KOSOVË E LIRË

**S**hpallja e Pavarësisë së Kosovës është bërë më 17 shkurt të vitit 2008, në orën 15:39, në Kuvendin e Republikës së Kosovës në Prishtinë. Në një mbledhje të jashtëzakonshme, ku merrnin pjesë 109 nga gjithsej 120 deputetë, Kuvendi i Kosovës njëzëri shpalli Kosovën shtet të pavarur, sovran dhe demokratik.

Ligjshmëria e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës për një kohë ka qenë temë e diskutueshme. Serbia, duke kundërshtuar Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës, kërkonte vlerësimin e vlefshmërisë ndërkombëtare dhe mbështetje për pozicionin e saj, gjoja se Deklarata e Pavarësisë së Kosovës ishte e paligjshme. Në vazhdim të kësaj ecurie, në tetor të vitit 2008, Serbia kërkoi një opinion këshillues nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë.

Më 22 korrik të vitit 2010, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë përmes një Vendimi Këshillëdhënës rikonfirmoi se Deklarata e Pavarësisë së Kosovës nuk ka shkelur asnjë nen të Ligjit Ndërkombëtar.

## Deklarata e Pavarësisë së Kosovës

“Ne, udhëheqësit e popullit tonë, të zgjedhur në mënyrë demokratike, nëpërmjet kësaj Deklarate, shpallim Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Kjo shpallje pasqyron vullnetin e popullit tonë dhe është në pajtueshmëri të plotë me rekomandimet e të Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara, Marti Ahtisaari, dhe Propozimin e tij Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës.”

17 shkurti i vitit 2008 shënon një nga datat më të rëndësishme të historisë së Kosovës dhe përmbyll sakrificën e popullit shqiptar të Kosovës për liri e pavarësi.

Kjo datë rrjedh si kontribut i gjeneratave të tëra, të cilat kërkesë të vetme e kishin pavarësinë e Kosovës dhe çlirimin e saj prej Serbisë. Këtu, nuk duhen harruar simbolet e rezistencës kombëtare dhe kontributi i heronjve, të cilët nuk kursyen jetën për të patur hisen e diellit të tyre: Isa Boletini, Hasan Prishtinës, Azem Bejtës e Shotë Galicës, Shaban Polluzhës, Ahmet Delisë, Afrim Zhitisë e Nuhi Berishës, Jusuf e Bardhosh Gërvallës, Kadri Zekës, Luan Haradinajt, Adrian Krasniqi, Edmond Hoxhës, Zahir Pajazitit, Hakif Zejnullahut, Xhevë e Fehmi Lladrovci, komandantit Adem Jashari e familjes së tij dhe mijëra heronjve dhe dëshmorëve të tjerë. Nuk duhet harruar gjaku i baballarëve, nënave, vëllezërve dhe motrave që u vranë, u masakruan dhe terrorizuan nga ushtria dhe policia serbe në masakrën e Izbicës, Rezallës, Reçakut, Lybeniqit, Qyshkut, Studimes, Pastaselit, Krushës së Madhe, Burgun e Dubravës, dhe mijëra martirëve të tjerë. Nuk duhen harruar eshtrat e pleqve, grave, të rinjve dhe fëmijëve të zhdukur të Mejës, Krushës, Lybeniqit, Gjakovës, Pejës, Mitrovicës, Fushë Kosovës, Klinës, Dubravës, e mijëra të zhdukurve të tjerë, ku fati edhe i mbi 1600 personave akoma nuk dihet. Nuk duhen harruar gjymtyrët, plagët dhe kontributi i mijëra invalidëve dhe ushtarëve



të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pa të cilën luftë çlirimtare Kosova nuk do të kishte liri dhe pavarësi. Nuk duhen harruar vuajtjet e dënimeve në burgjet jugosllave të patriotëve shqiptarë, të rinisë së Kosovës dhe lëvizjeve të brezit të 1968, 1981 dhe 1997, të cilët rezistonin me ide të flakta për flamur, pavarësi dhe liri. Nuk duhet harruar rezistenca paqësore e viteve '90 dhe aktivitetin e lëvizjeve politike shqiptare në Kosovë. Nuk duhet harruar roli dhe kontributi i mësuesve, sidomos gjatë viteve të '90, të cilët nën masa të dhunshme mbanin gjallë pa asnjë qindarkë mësimin shqip në shtëpi shkolla, duke edukuar gjenerata të tëra në kushte

mizore. Nuk duhen harruar marshet dhe aksionet humanitare, si marshi i grave me bukë në dorë nga Prishtina për në Drenicë me thirrjen “Bukë për Drenicën”, kjo me të vetmen arsye: sakrifikim me ta dhe ndarjen e bukës së gojës për njëri-tjetrin. Nën shqiptare janë sakrifikueset më të mëdha, janë heroinat tona.

17 shkurti 2008, shënon edhe përmbylljen e amanetit të të gjitha gjeneratave për liri dhe pavarësi. Rëndësia e pavarësisë njëkohësisht shënon edhe përmbylljen e elementit thelbësor, ndërtimin e institucioneve të pavarura të Republikës së Kosovës edhe pse ishin për një kohë nën mbikëqyrjen ndërkombëtare. Qeveria

e Republikës së Kosovës me institucionet e saj do të ndërmarrin masa të brendshme por edhe të jashtme për konsolidimin e shtetit të Kosovës. Si rëndësi të posaçme kjo nënkuptonte ndërtimin e Kushtetutës, si akti më i lartë i një shteti, prej nga janë të definuara qartë ndërtimi i hallkave institucionale dhe ndarjes së pushtetit, po ashtu funksionimi i tyre, laiciteti shtetëror, orientimi dhe profili shtetëror demokratik, liritë dhe të drejtat e njeriut, etj. Rëndësi tjetër e pavarësisë është edhe krijimi i simboleve të Republikës së Kosovës, flamurit, stemës, dhe himnit shtetëror, përmes së cilave Kosova do të identifikohet në rajonin vendor dhe ndërkombëtar.

Gjithashtu, rëndësi të veçantë ka edhe krijimi i dokumenteve zyrtare, dokumenteve identifikuese dhe pasaportës së Republikës së Kosovës, ky moment historik që sjell një rrëfim ndryshe për shtetin e ri të Europës. Pavarësia e institucionit të Policisë së Kosovës shënon rëndësinë sublimë të Republikës së Kosovës, prej të cilëve qytetarët do të jenë të sigurt, të mbrojtur dhe mbi të gjitha nuk do të ndjehen të kenë frikë, ku policia e Millosheviqit kishte sjellë pasiguri, frikë, traumë, vrasje dhe mizori te populli shqiptar në Kosovë. Pavarësia e Kosovës shënon rëndësi për të gjithë Ballkanin, sepse u krijua një stabilitet afatgjatë, duke garantuar siguri për tërë rajonin në veçanti por edhe për Evropën në përgjithësi.

Në rrafshin ndërkombëtar, rëndësi e posaçme ishte krijimi i Ministrisë të Punëve të Jashtme, Kosova nuk kishte pasur ambasada, nuk kishte diplomaci, dhe kjo në rrafshin ndërkombëtar nënkuptonte krijimin e një partneriteti të ri me shtetet e botës. Në këtë fazë të parë, më rëndësi historike është fakti se shtetin e Kosovës, të parët e njohën SHBA-të, duke u njohur edhe nga më shumë se 113 shtete për dhjetë vjet, dhe se krahas njohjes ndërkombëtare, ka pasuar edhe një vendim pozitiv nga GjND-ja për statusin e Kosovës, i cili është qartësisht i mbështetur në akte ndërkombëtare. Rëndësi tjetër e posaçme e kësaj date, janë edhe zhvillimet që do të ndodhnin në Kosovë në aspekte të ndryshme të jetës politike, sociale, arsimore, infrastrukturale etj., për shkak se Kosova gjendej në një pozitë jo të favorshme të zhvillimit rural dhe rajonal. Pavarësia e Kosovës rrjedh mbi sakrificën e gjeneratave të tëra dhe rëndësia e saj historike është e jashtëzakonshme, sepse është e vullosur me gjakun e heronjve, dëshmorëve dhe martirëve të kombit. Ata janë rojet e institucioneve të shtetit të Kosovës, janë emblema më e rëndësishme për lirinë, demokracinë dhe pavarësinë e Kosovës.

## 10 fakte mbi 17 shkurtin 2008

- *Shpallja e Pavarësisë së Kosovës është bërë më 17 shkurt të vitit 2008 në orën 15:39 në Kuvendin e Republikës së Kosovës në Prishtinë.*
- *Dizajnuet i flamurit dhe i stemës së Kosovës është Muhamer Ibrahim.*
- *Të parët që nënshkruan deklaratën e pavarësisë së Kosovës ishin: presidenti Fatmir Sejdiu, kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, si dhe kryeministri i vendit, Hashim Thaçi.*
- *Shtetet e para që njohën Kosovën si shtet pas shpalljes së pavarësisë ishin: Kosta Rika, SHBA, Franca, Afganistani, Shqipëria, Turqia, Britania e Madhe etj.*
- *Pergamena e vjetër 200-vjeçare, në të cilën është nënshkruar Deklarata e Pavarësisë së Kosovës, gjendet në zyrën e kryetarit të Kuvendit.*
- *Përveç pergamenës, aty gjenden edhe lapsi me të cilin janë vënë nënshkrimet, listat e nënshkrimeve të deputetëve pjesëmarrës në seancë, si dhe flamuri i vendosur në Seancën e Shpalljes së Pavarësisë.*
- *Muzeu i Londrës ishte ai që ia fali Kosovës pergamenën për shpalljen e pavarësisë.*
- *Flamujt e parë të Republikës së Kosovës janë shtypur në Turqi.*
- *Himni i Kosovës, i kompozuar nga kompozitori Mendi Mengjiçi, për herë të parë ishte intonuar në seancën e shpalljes së pavarësisë së Kosovës.*
- *Yjet e bardhë në flamurin e Kosovës simbolizojnë komunitetet e ndryshme që jetojnë në Kosovë, harta e verdhë simbolizon pasurinë e Kosovës, ndërsa ngjyra e kaltër simbolizon Evropën.*



# UDHËTIMI HISTORIK I QYTETEVE SHQIPTARE

Vlora në lashtësi quhej Aulona. Ajo përmendet nga shumë udhëtarë dhe kronikanë të huaj, si një nga qytetet - skelë kryesore të Ilirisë së Jugut, që lulëzoi pas rënies së Apolonisë dhe Orikut.

Emri i Vlorës është ndër të paktët emra gjeografikë të bregdetit lindor të Adriatikut që i ka qëndruar kohës qysh nga lashtësia. Në bregdetin e banuar sot nga popullsia shqiptare, ky emër gjeografik del i një lashtësie pak a shumë të përafërt me ato të Durrësit, Shkodrës, Lezhës dhe Ulqinit. Këta emra gjeografikë nuk do t'i kishin rezistuar kohës, në rast se vendbanimet e emëruara prej tyre nuk do të kishin pasur një vazhdimësi përdorimi në radhë të shekujve.

Sipas materialeve arkeologjike dëshmohej se në bregdetin e Vlorës, ashtu edhe në prapavijën e tij, për vendbanime parahistorike e zhvillime ekonomike-kulturore të shumë qytezave e qendrave urbane dallohej karakteri i tyre fortifikues, mbrojtës.

Të tilla janë ato të “Shpellave të Velçës”, “Shpellave të shkruara të Lepenicës” (nga më të rrallat në Ballkan e Mesdhe), “Shpellat e Spilesë” (Himarë) apo “Mozaikët e Mesaplikut”, pasuri e rrallë kombëtare. Vendbanimet tumulare të Vajzës, Dukatit, Mavrovës, “Pitosa” të Mallkeqit tregojnë për autoktoninë dhe vazhdimësinë etno-kulturore të ilirëve në periudhën e bronzit dhe të hekurit.

E njëjta gjë dëshmohej edhe në vendbanimet e tjera të lashtësisë që janë qytete-kala si Amantia, Olympia, Kanina, Himara, Cerja, Armeni, Hadëraj, Triporti dhe vetë Vlora (Aulona) etj.

Amantia, e themeluar në shek. V p.e.s., është një nga qytetet e pakta të Ilirisë jugore që ka pasur jetë 1000 vjeçare, ku spikat më shumë ndërtimi në terren malor i stadiumit antik madhështor, i ndërtuar me blloqe të mëdhenj gurësh.

Në jug të qytetit të Vlorës gjendet qyteti i Orikumit, i cili ka qenë një nga portet më të lashtë të bregdetit të Vlorës, i themeluar si vendbanim në shek. VI-V p.e.s.

Oriku u bë port i fortifikuar, bazë e rëndësishme ushtarake në Adriatik dhe në shek. II-I p.e.s. ishte kantier i rëndësishëm detar për ndërtim e riparim anijesh, gjë që favorizohej nga prania e madhe e pyllit me pisha të Llogorasë dhe Sera e Selenicës. Në shek. I p.e.s. Oriku shërbeu si kryeurë e fuqive pushtuese të kohës, arenë luftërash midis Romës, Maqedonisë dhe Ilirisë, si dhe në luftën rivale midis Çezarit e Pompeut, që i sollë Orikut shumë shkatërtime. Në shek. II p.e.s., Oriku u godit nga një tërmet i fuqishëm dhe u shkatërrua duke e humbur rëndësinë e tij, pa mundur të rimëkëmbej më. Ishte pikërisht koha kur në gjirin e Vlorës del në pah një tjetër qytet-skelë, që ishte Aulona - Vlora e sotme.

Dëshmi arkeologjike e lashtësisë dhe autoktonisë është edhe vetë simboli i saj, “Vajza aulonase”, një skulpturë “Hyjnesh” 87cm, e gdhendur nga mjeshtrë vendas me gurin gëlqeror të Kaninës, që simbolizon veshjen e grave



ilire.

Emrin e qytetit - skelë të Aulonës së lashtë e gjejmë të përmendur në shek. II e. s., nga shkrimtari Lukani dhe nga gjeografi Aleksandrin Ptolemeu. Këto të dhëna burimore përputhen me të dhënat e tjera të përafërta, siç janë dëshmitë arkeologjike për një kështjellë, port e bankinë të madhe (kështjella e Jangjeçit, Triport), që kanë ekzistuar ndoshta kur lumi Vjosa e kish grykëderdhjen aty në Lagunën e Nartës. Por, ndoshta kur Vjosa u largua në drejtimin verior, Triporti humbi mundësinë dhe rëndësinë. Pikërisht në këtë kohë duhet të ketë origjinën Aulona, port i spostuar në JL, e cila del si skelë - qendër tregtare dhe Kanina qendër administrative - ushtarake në shek. VI e. s. Fakti që në shek. V-VI e. s., ka pasur në Vlorë edhe një peshkop, varur nga mitropolitin i Durrësit, tregon se Aulona ka qenë vendbanim me rëndësi. Këtë e mbështet edhe zbulimi i viteve të fundit i traktatit të murit rrethues mbrojtës, fortifikues në qendër të qytetit të sotëm të Vlorës (pranë monumentit të Pavarësisë) si dhe zbulimi i disa dëshmimeve të reja për ekzistencën e molit të vjetër, në afërsi të stacionit të trenit.

Gërmimet e fundit në Kaninë dhe Himarë kanë dhënë dëshmitë e tjera për kulturën ilire të antikitetit të vonë dhe mesjetës së hershme, për autoktoninë dhe vazhdimësinë ilire-arbërore dhe mesjetare shqiptare. Në shek. VI e. s. dhe vazhdimisht gjatë mesjetës, Aulona përmendet në listën e qyteteve bregdetare si port i rëndësishëm, me detari të zhvilluar, që tregton vaj ulliri, kripë, valanidh, lëndë drusore, ullinj si dhe panairit që bëheshin në afërsitë e Vlorës, ashtu edhe në vende të ndryshme të Europës. Edhe në grykën e Vjosës ishte skela e Spinariçës, ku zhvillohej tregti dhe aty ishin të pranishëm edhe konsuj tregtarë të Raguzës, Venedikut etj. Në mesjetë Vlora dhe viset e saj ranë nën pushtimin norman më 1081, më pas nën pushtimin e Venedikut më 1205 dhe atë të sundimit të Hohenstaufenëve gjermanë, siç e përshkuan edhe Jireçku në studimin e tij.

Si një qendër e zhvilluar dhe e kulturuar Vlora shfaqet edhe në mbretërinë e Arbërisë më 1272, ku kronikat e kohës shënojnë lulëzimin e zejtarisë, tregtisë, blegtorisë dhe pemëtarisë, të përfshirë si

despotat më vete.

Një rol të madh në jetën politike, ushtarake e shoqërore të Vlorës, ka luajtur edhe familja e madhe Arianite, të cilët përmenden në shek. XI, nëpërmjet të parit të tyre Arianit Komnen Golemi Topisë, sidomos në shek. XV-XVI. Një nga figurat e shquara të shek. XV është Gjergj Arianiti, i cili organizoi qëndresën kundër pushtuesve osmanë, më 1431-1432, e më pas në grykat e Labërisë. Me bëmat e tij, Gjergj Arianiti mori përgëzimet e Fuqive të Mëdha të Europës të asaj kohe. Edhe pse ishte aleat me Gjergj Kastriotin Skënderbeun dhe vjehrrin e tij, pasi Donika, e bija e tij u martua me Skënderbeun, Gjergj Arianiti ishte i pavarur në zotërimet e tij në jug dhe në Shqipërinë e Mesme. Në Kuvendin e Lezhës, më 2 mars 1444, për t'i bërë ballë rrezikut të pushtimit osman, Gjergj Arianiti u radhit ndër të parët krerë sundimtarë shqiptarë, në këtë lidhje ushtarake mbarëkombëtare. Në shek. XV-XVI pushtuesit osmanë e kthyen portin e Vlorës në një nyje të rëndësishme të Adriatikut për pushtimin e Italisë. Në regjistrin turk të vitit 1520 shënohen 701 familje vendase dhe 531 familje çifute. Kjo dëshmon për një klimë paqësore e tolerancë ndaj çifutëve në qytet, në një kohë kur gjetke ata persekutoheshin egërsisht. Kështu qyteti përmblihte

“Flamurtari”), gurët e së cilës u morën nga kështjella e Jangjeçit në Zvërnec dhe nga muri rrethues i Aulonës.

Në shek. XVII-XVIII Vlora ishte një nga limanet më të rëndësishëm të Shqipërisë së Jugut, pas Prevezës, pasi gjiri i saj u siguronte anijeve mbrojtje nga stuhitë. Në skelën e Vlorës ishin ndërtuar depo të mëdha për grumbullimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale të fshatarësisë, ku përfshiheshin zona e Beratit, Gjirokastrës dhe Myzeqesë. Në eksportin e tij ky qytet zhvillonte tregti me Triestën, Venedikun, Vjenën, Korfuzin, Stambollin, Izmirin, Breshian, Barin, Manastirin, Janinën, Maltën e Qipron. Në portin e Vlorës hynte rregullisht çdo javë vapori austriak “Lloid” dhe ai italian “Pulja”, të cilët vetëm për vitin 1904 kishin kryer respektivisht 224 dhe 181 hyrje-dalje. Vlora eksportonte: vaj ulliri - 20 000 fuçi, ullinj të velur 11 000 barrë, kripë 1.5 milion kilogram, lesh të palarë - 15 000 okë, lëkurë qengji e lepuri - 20 000 copë, breshka - 40 000 copë, shushunja, shpendë, dele, kuaj, mish të therur, peshk të kripur, vezë peshku, serë, asfalt, misër, tërshërë, thekër, fasule, dru zjarri, valanidh, mjaltë të bardhë Kanine, verë të Nartës dhe verë “Vlosh” të Vlorës.

Një artikull i kërkuar ishte edhe stralli i gurores së Drashovicës, që përgatitej me blloqe dhe ashkla. Për eksport,



6300-6500 banorë. Nga Vlora u nisën fuqitë ushtarake osmane kundër Italisë së Jugut, më 1480, kundër kryengritjes së himarjotëve më 1492 dhe shërbeu si bazë e sulltan Sulejmanit kundër Korfuzit, më 1537. Po në këtë vit u ndërtua kështjella e qytetit (aty ku sot ndodhet stadiumi

gëzofët prej lëkure, velenxat dhe bruçat labe ishin artikuj mjaft të preferuar për Istriën, Triestën dhe vendet alpine... Ulliri i markës “Vlonjak”, që ishte më i lashtë se marka italiane dhe frënge, dallohej për prodhueshmëri të lartë, vaji dhe regjije lëkure. Në vitin 1900 Vlora regjistronte

mbi 100 000 rrënjë ullinj.

Vlora njihet si një vatër e rëndësishme e patriotizmit ndër shekuj, ku përpjekjet për liri, pavarësi dhe prosperitet kanë qenë në shpirtin e çdo vlonjati.

Luftërat kundër pushtimeve të huaja dhe përpjekjet për përhapjen e arsimit shqip bënë që në Vlorë të krijoheshin shumë shoqëri patriotike.

Në vitet 1908-1912 klubi “Labëria” u bë një vatër e ndezur e përpjekjeve për pavarësinë e vendit dhe luftën kundër pushtuesve xhonturq. Kryetar nderi i këtij klubi atdhetar ishte Ismail Qemali. Çelja e shkollës shqipe të Muradies (7 gusht 1908) ishte një ngjarje e shënuar në jetën arsimore të Vlorës.

Por ngjarja më kulmore e qytetit të Vlorës ishte 28 nëntori 1912, kur plaku i urtë e diplomati i shquar Ismail Qemali, së bashku me delegatët e ardhur nga vise të ndryshme të vendit, shpalli pavarësinë e Shqipërisë dhe njëkohësisht ngriti flamurin kombëtar në Vlorë. Kështu Vlora u bë kryeqyteti i parë i Shqipërisë së pavarur. Më 25 dhjetor 1914 Vlora u pushtua nga Italia fashiste. Pas zgjerimit të pushtimit italian nisi rezistenca kundër pushtuesve. Në vitin 1920, pas Kongresit të Lushnjës, u krijua Komiteti “Mbrojtja Kombëtare” me kryetar Osman Haxhiun, i cili organizoi forcat luftarake në Luftën e Vlorës. Lufta e Vlorës është një nga epopetë më të lavdishme të shqiptarëve. Vlora u kthye në “Termopilet” e Shqipërisë.

Në vitet 1920-1924, Vlora u përfshi në rrjedhën e proceseve të demokratizimit të jetës së vendit. Këtu u krijua Federata “Atdheu” (1921) dhe dega e shoqërisë “Bashkimi” (1922). Një rol të madh në këto vite ka lozur edhe shtypi me gazetat “Politika”, “Mbrojtja Kombëtare”, “Fjala e Lirë”, “Shpresa Kombëtare” etj. që botoheshin në Vlorë.

Në Luftën e Dytë Botërore Vlora u bë një nga vatrën e rëndësishme të Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare kundër pushtuesve nazifashistë. Ajo mbajti një barrë të madhe të Luftës dhe kontributi i saj ishte i shquar.





Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

### Përgatitja si ushtarak dhe fillimet si antifashist

Ismail Karapici lindi në qytetin e Tiranës, më 14 dhjetor 1922. Në qytetin e Tiranës mori edukimin e parë, duke ndjekur shkollën fillore dhe më pas plotore. Në moshën 18-vjeçare, në vitin 1935, fitoi bursën shtetërore. Kalon Adriatikun dhe nis studimet në Kolegjin Ushtarak të njohur "Nunziatella", në qytetin e Napolit. Pushtimi i Shqipërisë nga fashistët ngjalli një revoltë të natyrshme, të përligjur tek studentët ushtarakë shqiptarë në Itali përfshi edhe qytetin e Torinos, ku gjendej Akademia Ushtarake e Artilerisë dhe Xhenios, në të cilën studionin mjaft kadetë për oficerë nga Shqipëria. Në këtë shkollë u njoh dhe me shqiptarë të tjerë si Hamit Keçi nga Tirana, Qazim Kapisyzi nga Shkodra, Xhemal Punavija e Hasan Fariçi nga Mati, si dhe Xhavit Topçiu e disa të tjerë. Me përfundimin e studimeve në "Nunziatella", vijoi përsëri studimet në Akademinë Ushtarake të Artilerisë dhe Xhenios, në qytetin e Torinos. Ismaili, si shumë studentë të tjerë ushtarakë shqiptarë në shkollat dhe akademitë ushtarake të Italisë, e përjetoi dhe e përcollti me trishtim dhe revoltë pushtimin fashist të Shqipërisë. Ndaj, dhe i nxitur prej ndjenjave patriotike dhe atdhetare, në bashkëpunim me atdhetarë të tjerë, menduan të protestonin hapur kundër pushtimit, në Itali. Për këtë qëllim ata zgjodhën një mënyrë krejt të veçantë, një atentat kundër vetë kreut fashist italian Benito Musolinit! Sipas traditës dhe rregullit, ushtarakët dhe studentët shqiptarë në Itali, bënë Betimin Ushtarak. Ishte përcaktuar dhe fiksuar data 29 maj 1939 për Betimin. Por, Policia dhe Karabinieria italiane kishin të dhëna se në Torino po përgatitej një atentat prej studentëve shqiptarë të Akademisë Ushtarake të Artilerisë dhe Xhenios kundër vetë Musolinit, gjatë vizitës së parashikuar prej tij në këtë qytet. Autoritetet urdhëruan që studentët të dërgoheshin në Romë. Në kryeqytetin italian do të kryhej Betimi për të shmangur atentatin e përfolur kundër liderit italian.

Përveç atentatit, flitej dhe për kundërshtim ndaj Betimit prej disa oficerëve dhe studentëve shqiptarë që ndodheshin me studime në Itali. Ibrahim Osman Toçi, i cili ndodhej në kryeqytetin italian për kualifikim ushtarak, ishte shprehur hapazi kundër Betimit. Por, ...together Toçi u gjend i vetëvrarë me armën e tij në një moment emocional dhe tensioni. Muaj pas hetimeve, Policia dhe Karabinieria italiane zbardhën planin e atentatit të mbetur në tentativë. Në përfundim të tyre, sipas autoriteteve italiane, ku në qendër të planit të atentatit, organizator e nismëtar ishte njëri prej studentëve shqiptarë të Akademisë Ushtarake torineze, student i ushtarak Ismail Karapici. Autoritetet fashiste në Itali, pas hetimeve, identifikuan Ismail Karapicin si strumbullar të "atentatit" të Torinos, i cili e pranoi fajin. Në përfundim kundër organizatorëve dhe pjesëtarëve, u morën "masa sigurie". Në datën 21 tetor 1939, Komisioni për Dëbimet, i Ministrisë së Brendshme në Tiranë, lajmëronte se, për ngjarjen e Torinos ishin dhënë gjashtëmbëdhjetë dënime me dëbim nga Italia, kurse pesë të tjerë me burgim. Katërmëdhjetë prej dënimeve u përkisnin studentëve ushtarakë shqiptarë të Akademisë Ushtarake të Torinos. Dënimi më i rëndë iu dha

# ISMMAIL KARAPICI,

## nga burgu, me shpëtimtarët aleatë dhe me misionin amerikan



Ismail Karapicit, me pesë vjet burgim. Pesë vjet burg natyrisht e përforcuan dhe formatuan qartë shpirtin antifashist të djaloshit ushtarak shqiptar që i kishin pushtuar atdheun pak më parë se një muaj!

### E nxorën nga burgu shpëtimtarët aleatë

Në librin e autorit shqiptaro-amerikan, "Misioni Amerikan në Shqipëri", i gazetarit Peter Lucas, shkruhet se Ismail Karapici i vuajti vitet e burgimit në Itali. Atë e liruan Aleatët, pas çlirimit të Italisë në Korrik 1943, nga një burg Italian. Kur Aleatët hapën frontin e luftës me Italinë fashiste, ata liruan të gjithë të burgosurit politik. Në Bari, amerikanët gjetën midis tyre mjaft antifashistë të vendosur, të gatshëm, për të luftuar pushtuesin e ri nazist edhe në Shqipëri. Midis tyre ishte dhe Ismail Karapici, i cili pak kohë më pas do të ishte pjesë e misionit ushtarak anglo-amerikan në Shqipëri. Siç dihet, misionet e para britanike në Shqipëri erdhën nëpërmjet Greqisë nga fundi i muajit prill dhe fillimi i muajit maj 1943, në ish-Qarkun e Gjirokastrës e të Korçës. Këto përbëheshin nga nënkolonel Bill Maklin, major Davit Smajli dhe kapiten Gerri Dali Duffi. Në datën 9-10 gusht 1943 në qarkun e Korçës u hodhën me parashutë edhe 4 oficerë të tjerë britanikë: major Bill Tilmon, major Gerri Fild (Fidani), major Xhon Semur dhe major Peter Kemp (njerka). Ata erdhën në kohën që do të krijohet Br. I S. Ndërsa majori Gerri Fild u dërgua në jug-perëndim të Vlorës (Dukat), ku LNÇ ishte më e dobët.

Oficerët anglezë kishin marrë udhëzime, që të ndihmonin cilëndo forcë politike ose grupim në Shqipëri që do të luftonte kundër forcave pushtuese. Majori Gerri në Dukat shkoi nga muaji shtator 1943. Ai mori pjesë në dorëzimin e garnizonit italian në Qafë të Përrallit në Dukat. Në muajin nëntor 1943, majori anglez, si dhe disa amerikanë, në përbërje të tyre dhe major

Ismail Karapici, me origjinë tiranase, ngritën bazën detare të Gramës, e vetmja në Shqipëri. Kjo bazë shërbeu për t'u lidhur me aleatët në komandën e Mesdheut në Kajro të Egjiptit e më pas kaloi në Bari të Italisë. Prej këtej transportoheshin armatime e municione, veshmbathje, ushqime, të plagosur, misione, ndoshta edhe forca të aleatëve që vinin në Shqipëri. Pra ndihmoheshin të gjitha forcat që luftonin pushtuesin. Ismail Karapicin e vlerësonte edhe autorit shqiptaro-amerikan, Piter Lukas, në librin e tij "Misioni Amerikan në Shqipëri", botuar edhe në shqip, i cili e ka ndeshur emrin e tij nëpër dokumentet e arkivave amerikane dhe në librat apo kujtimet e ish-misionarëve që vepruan në bazën e Dukatit, në vitet 1943-1944. Major Xhelil Imeri që nga fillimi punoi me misionet anglo-amerikane pasi zotëronte mirë gjuhën angleze dhe italiane. Ai organizoi marrjen e rojeve që ruanin bazën dhe shoqëronin oficerët të saj. Me bazën e Gramës mbanin lidhje drejtuesit e LANÇ-it Hysni Kapo, Shefqet Peçi etj. Ndërsa nga BK mbanin lidhje Skënder Muço dhe disa të tjerë. Misionet fillimisht i prunë BK në Dukat armatime dhe veshmbathje, pasi, si e panë që kjo forcë nuk hodhi as një pushkë kundër gjermanëve, i ndërprejnë ndihmat sepse ky ishte kushti kryesor i anglo-amerikanëve. Ndërsa për forcat partizane anglo-amerikanët e Gramës organizuan hedhjen me parashutë të armatimit dhe veshmbathjes në Ramje të Dukatit në kufi me Tragjasin dhe në malet e Tragjasit.

### Prezantimi i Karapicit me misionet

Por në historinë e sjellë në librin e ish-misionarit anglez, që ishte vendosur po ashtu në bazën e quajtur "Seawiev" të Karaburunit, në Vlorë, të aktorit të njohur dhe majorit A. Kuajle, ashtu si dhe në librin e autorit shqiptaro-amerikan Piter Lukas, mbetet e paqartë çështja për rreshtimin e tij në grupimin luftarak "joqeveritar", midis atyre që u

ngritën nga forcat politike dhe vepruan në skenën e LANÇ-it në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore. Për pasojë gjithkush që i lexon botimet e këtyre autorëve do të mbetet i paqartë lidhur me personazhin Ismail Karapici, i cili shërbente në përbërje të misionit ushtarak amerikan, të koduar OSS, në zonën e Dukatit të Vlorës.

Majori anglez, Antoni Kuajle, në takimin e parë të njohës me Ismail Karapicin në bazën "Seawiev" (Panorama), në librin "Tetë orë nga Anglia", shkruan: "Tamam në këtë kohë një burrë i vogël me uniformë amerikane hyri në shpellë. Oh, harrova t'u them. Kemi një mik sonte, - tha Bensoni, pjesëtar i misionit anglez të major E. Kuajles. Më lejoni t'u prezantoj, Ismail Karapici, majori Overton! I dhamë dorën njëri-tjetrit". Lidhur me prezantimin dhe përshkrimin që i bëhet figurës së I. Karapicit, ai paraqitet si një "burrë trupvogël, tejet i shkathët që, megjithëse bashkëvepronte me misionin ushtarak të "Panoramës", bazës së tyre në Karaburun, ...nuk fliste anglisht, por italisht dhe frëngjisht të rrjedhshme". Karapici i zotëronte dhe i fliste gjuhët e huaja, sepse kishte studiuar në shkollat ushtarake, si në Kolegjin e Napolit dhe Akademinë Ushtarake të Torinos.

### Veprimtaria e antifashistit Ismail Karapici

Ismail Karapici ishte një antifashist i orëve të para, i vendosur dhe aktiv. Veprimet e tij në Itali, organizimi i komplotit kundër Musolinit, arrestimi dhe burgosja nga regjimi fashist, lirimi dhe bashkëpunimi me misionet anglo-amerikane në zonën e Dukatit në Vlorë, janë argumente më të pakundërshtueshme se ai ishte antifashist. Kjo bindje përfordhet më shumë nëse i referohemi shkrimeve të autorëve të përmendur më herët, të cilët dëshmojnë se ai ishte kundërshtar me ballistët inaktivë dhe bashkëpunëtorë me gjermanët nazistë. Por ai simpatizonte

dhe mbështeste partizanët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, konkretisht Br. V S, e cila vepronte e luftonte në zonën e Vlorës dhe pranë fshatit Dukat. Megjithatë, ai nuk ngurronte të kritikonte ndonjë veprim ekstremist të tyre, që ai e vlerësonte si terrorist, teksa shtonte: "...Por, unë nuk jam terrorist!". Në vlerësimet që i bënin misionarët ushtarakë amerikanë, por dhe anglezë, e vlerësonin Ismail Karapicin për njohuritë dhe aftësitë e spikatura në kryerjen me sukses të detyrave të shërbimit informativ, në interes të idealeve dhe botëkuptimit të tij antifashist për çlirimin e vendit nga pushtuesit e huaj. Ata e vlerësonin "si komunist dhe mbështetës i forcave të Ushtrisë NÇSH, por dhe që nuk kishte asgjë të përbashkët, madje i dënonte veprimet ekstremiste të reparteve partizane pasi ishte një komunist idealist". Thëksojmë se "ai ishte pro luftës kundër fashizmit dhe nazizmit, madje ndër të parët që e nisi atë me përpjekjen për atentat kundër kreut fashist italian Benito Musolinit, prandaj i kritikonte ashpër hezitimet e grupimeve nacionaliste për luftë kundër pushtuesve nazistë".

Nuk është e vështirë të kuptohet në cilën anë ishte Ismail Karapici, jo vetëm sepse bashkëvepronte me aleatët amerikanë në Shqipëri, por edhe teksa shprehej hapur dhe vlerësonte luftën kundër pushtuesve të forcave të UNÇSH-së, simbolet e të cilëve shpesh mbante veshur (kujtoni kapelën me yll). Ndërkohë, ai mbante një qëndrim të prerë dhe kritik ndaj pasivitetit dhe sjelljes pro pushtuesit dhe bashkëpunues me të, që shpesh mbante Balli Kombëtar dhe forcat luftarake të tij. Në këto rrethana është qartazi e kuptueshme që Ismail Karapici ishte një antifashist tërësisht i bindur dhe i vendosur në luftën për çlirimin e vendit dhe popullit të tij dhe këtë e konfirmon fakti se ai si i tillë u vra, ndonëse lufta ende vazhdon. Por, askush nuk mund të provojë nëse ishte komunist. Ai u vra në afërsi të bazës së ngritur nga aleatët pranë fshatit Dukat, më 17 shkurt 1944, në një pritë të dyshimtë, për të cilën pati shumë dyshime dhe hamendësime. Sidoqoftë ai luftoi dhe ra për një çështje të drejtë, luftoi kundër fashizmit dhe nazizmit si dhe për çlirimin e atdheut të tij. Ismail Karapici, për shumë kohë ngeli i harruar, por Instituti i Studimit të Historisë ushtarake, në vitin 2016, organizoi sesionin shkencor-përkujtimor për personazhin historik ushtarak, pak ose fare pak i njohur në historinë e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare Shqiptare. Për këtë i propozoi për t'u shpallur Dëshmor i Atdheut, Komisionit Qendror të Statusit të Dëshmorit pranë MM. Ismail Karapici u shpall dëshmor me vendim nr. 796, datë 15.08.2020. Po ky Institut i ka propozuar Bashkisë së Tiranës për vendosjen e emrit të tij në një rrugë të Tiranës, pasi familja Karapici është e njohur edhe si një nga familjet e vjetra të Tiranës.

# Nga biseda në Nju Jork me skënderbegasin Bashkim Muhedini, legjendën e portës së "Partizanit" dhe ekipit kombëtar

**N**arja nga jeta e Bashkim Muhedinit preku mbarë opinionin sportiv dhe jo vetëm. Ish-portieri ikonë i kombëtares shqiptare dhe i Partizanit ka ndërruar jetë në moshën 74-vjeçare, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, vend ku jetonte prej disa vitesh. Por miqtë dhe dashamirësit do e sillnin në kujtesën tonë nëpërmjet intervistës së tij dhënë përtej oqeanit, në vitin 2019.

*Qofsh i qetë në udhëtimin e përjetshëm ikona e 'portës' shqiptare.*

...Kush nga ne, që dëgjonim radion në vitet '60-'70, nuk e ka në vesh si një trak muzikor zërin e të madhit Ismet Bellova, kur transmetonte ndeshjet e futbollit, pikërisht këtë: "...Dhe pret Muhedini!" Sigurisht, të gjithë portierët atë bëjmë, presin topat, por edhe sot po të pyesësh sulmuesit e atyre viteve, të tregojnë se ç'do të thoshte të gjuaje një penallti me Muhedinin në portë: ishte pothuaj i humbur! Është e pritshme, e natyrshme, që tani që i ka kaluar të 70-at, me Bashkim Muhedinin, portierin legjendar të "Partizanit", një bisedë-intervistë ta bësh me një gotë raki dhe një pjatë meze përpara. Është po ashtu e natyrshme që biseda të bëhet për futbollin, aty ku emri i tij është gdhendur me format dhe ngjyrat e një ikone në dy kapituj të Historisë së Futbollit Shqiptar: Partizani dhe Kombëtarja. Megjithëse në ato kapituj mungojnë rreth 10 vite që Muhedini iu hoqën pa të drejtë nga veprimtaria sportive (e ndaluan të luante në moshën 28-vjeçare, në kulmin e aftësive dhe pjekurisë), për arsye që nga perspektiva e sotme duken të padrejta e madje qesharake, ato vite që kaloi me fanellën e kuqe dhe atë kuq e zi, janë vite të një sportisti të nivelit më të lartë. Bashkimi në portën e Partizanit dhe Kombëtares, zuri vendin e një tjetër legjende, Mikel Jankut, një ish-skënderbegas, por të dyja portat mbetën mbase dhe më të sigurta. Skënderbegasi shtatë nga Koblara e Frashërit famoz, i lindur më 16.4.1948, i rritur në Tiranë, nxënës i Shkollës "11 Janari", do të



binte në sy të mjeshtërvë të trajnimit (dhe mbase mund të ketë pasur dhe një luftë të heshur a gjysmë të hapur mes tyre), për ta tërhequr në ekipet e tyre. Ishte Mjeshtri Vangjel Koja që e futi dhe e ndihmoi në fillimet e veta sportive që në 7-vjeçare. Sigurisht, Koja do të donte ta bënte volejbollist të Dinamos, por ishte gjeneral Petrit Dume që e rrëmbeu, e veshi me uniformën e blertë të skënderbegasit,

dhe Bashkimi ra në duart më të mira për t'u bërë sportist cilësor.

I pari, Mjeshtri Njazi Lleshi, dhe po të vazhdonte aty ai do të bëhej një basketbollist i madh i Partizanit të madh të atyre viteve. Por djaloshi ra në sy të një tjetër Mjeshtri, Bejkush Birçes, që përfundimisht e futi në botën e futbollit, dhe i veshi fanellën me Nr. 1, atë të portierit. Cilësitë fizike, atletike, aero-dinamike të

portierit të ri ishin të nivelit më të lartë dhe ende skënderbegas i vitit të tretë, më 1966 kalon me ekipin e parë të Partizanit.

"Kisha një grup shokësh dhe futbollistësh të mrekullueshëm", - thotë Bashkimi, e përmend Pëllumb (Luke) Shaqirin, Gjergj Thakën, Torez Çirakun, Suvorov Seferin... "Por të lutem dua të theksosh Spiro Gjikën", - shton ai. "Shokë kisha dhe në sporte të tjera, Ismet Varfin, Kiço Musaqin... nga të gjithë kam kujtime të bukura, njerëz të mrekullueshëm, zemërmirë, me shpirt luftarak, të palodhur. Shkolla "Skënderbej" na dha shumë, shumë. Nuk diskutohet disiplina, rregulli, kompaktësia, ajo që quhet shpirti i skuadrës, i ekipit, por aty ne formuam jo vetëm trupin, fizikun, por së pari karakterin, mbase elementi më i rëndësishëm i një sportisti cilësor. Të kesh trajner një emër si Loro Boriçi, cilësitë fizike nuk janë mjaft. Ne kishim dhe një kapiten të rrallë, Lin Shllakun. Por Partizani, - më befason Bashkimi me këtë përcaktim, - kishte një komandant me meritë, Panajotin, Panajot Panon e madh! Ai flet me fjalët më të bukura, me një admirim që edhe pas 40-50 vjetësh, ka mbetur i pamatë, me një respekt e nostalgji të thellë, tepër njerëzor, për Panajotin. Në të gjithë vëllimet e këtij libri, lexuesi e gjen me dhjetëra herë të përmendur emrin e Bashkim Myhedinit, nga shokët e Shkollës dhe të ekipit, por nuk do të gjeni asnjëherë fjalë mos respekti a diçka të tillë. Por dhe Bashkimi i ka dashur dhe i ka respektuar ata, e kur ka mundur, i ka ndihmuar. Ai më tregon një rast kur mbrojtja e vendosur që i bëri një shokut të skuadrës, u përdor si argument edhe para Enver Hoxhës, dhe bashkëlojtari i tij kaloi një situatë të sikletshme, që me mendësinë e asaj kohe, mund t'i kushtonte më shumë se karriera sportive.

Në këtë bisedë-intervistë nuk kemi

marrë përsipër të bëjmë një historik të ndeshjeve dhe titujve që Muhedini zhvilloi dhe fitoi gjatë karrierës së tij sportive. Megjithëse ato nuk janë as pak e as të parëndësishme. Kupa e dytë Ballkanike e Partizanit më 1967, pas asaj të vitit 1946, mbetet një nga trofetë më të bukura të fillimit të karrierës sportive të portierit tonë. E po ashtu ndeshja me Torinon, më 1968, shtatë ndeshjet me ekipin Kombëtar, ndeshjet me RFGJ, RDGJ, Kinën... Në ato vite rruga e tij e jetës kryqëzohet me emra të mëdhenj të sportit shqiptar e atij botëror. Edhe me legjenda të tilla si Lev Jashin, Franc Bekenbauer, Netzer, Berti Vogst sa për të përmendur disa. E pastaj Iljaz Çeço, Pavlo Bukoviku, Fatmir Frashëri, Medin Zhega, Dinella, Kaçi, Perlat Musta... Por për këto të dhëna ka libra të tjerë, koleksione gazetash, faqe interneti, stenda muzeu. Ky libër është pjesë e një seriali për skënderbegasit në vite, dhe Mjeshtri i portës më mirëkupton kur unë e çoj bisedën në atë hulli. Madje dhe për jetën e tij, pasi u detyrua, - me dhimbje, me shumë dhimbje natyrisht, - ta ndërpriste karrierën sportive, nuk ka dëshirë të flasë shumë. Por flet me dashuri, passion e mirënjohje për shokët e klasës, mësuesit dhe komanduesit e asaj Shkollë të mrekullueshme. Edhe po ta pyesësh për një mendim profesional për sportin shqiptar, e për futbollin veçanërisht, thotë me modesti se "unë jam larg". Nga Nju Jorku sigurisht e ndjek, por Shqipëria ka specialistë dhe ata i dinë mirë punët e tyre. I vjen mirë për Partizanin e ringritur, për titullin kampion në sezonin 2018-'19 por nuk pretendon të japë këshilla. Përplasim gotat për shëndet e gëzime në jetë, dhe me urimin që të marrim gjithnjë lajme të mira nga Shqipëria.

*Nju Jork, 2019  
Nga Veri Talushllari*



# MUNDËSIA JOTE TË BËHESH PJESË E FORCAVE SPECIALE, EJA TESTOHU!

Dëshironi të punoni në Repartin më elitë të Forcave të Armatosura Shqiptare, siç është Batalioni i Forcave Speciale në Regjimentin e Operacioneve Speciale?!

Keni vullnetin dhe guximin që të sfidoni veten tuaj me stërvitje dhe trajnime, ku do të ndjeheni të vlerësuar më një trajtim financiar të shtuar, mbi vështirësinë e punës që bëni?!

Doni të profilizoheni në specialitete të ndryshme, me njohuritë më të mira për profesionin që do kryeni?!

Dëshironi mundësi të shumta trajnimesh dhe misionesh brenda dhe jashtë vendit, krah për krah me Forcat më elitare të NATO-s?!

Për të pasur të gjitha këto dhe jo vetëm, EJA BËHU PJESË E BATALIONIT TË FORCAVE SPECIALE TË REGJIMENTIT TË OPERACIONEVE SPECIALE!

Kandidatët që do të aplikojnë për të marrë pjesë në Kursin XIV Bazë të Forcave Speciale, të paraqiten pranë personelit të reparteve përkatëse, për të dorëzuar dhe plotësuar dokumentacionin e nevojshëm, ose ta plotësojnë atë te personeli i Regjimentit të Operacioneve Speciale. Regjistrimet hapen në periudhën 01-10 shkurt 2023.

Zhvillimi i testimit përzgjedhës do të jetë nga data 13-17 shkurt 2023.

Shpallja e kandidatëve fitues do të bëhet me datë 24 shkurt 2023.

*Kriteret për regjistrimin e kandidatëve janë:*

1. Të mos jetë i dënuar apo i ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë.
2. Të ketë gjatësi trupore mbi 170 cm.
3. Të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm, pa tatuazhe, mangësi apo shenja që deformojnë pamjen.
4. Të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatitit B dhe C.
5. Të mos ketë probleme me zemrën, veshkat, mushkëritë dhe mëlçinë.
6. Moshë maksimale për aplikim është 30 vjeç.
7. Të jetë ushtarak aktiv i Forcave të Armatosura Shqiptare (Oficer, Nënoficer, Ushtar).
8. Kandidatët Oficerë të jenë me gradën N/ Toger-Kapiten.
9. Kandidatët Nënoficer të jenë me gradën N/ Tetar-Tetar.
10. Kandidatët Ushtar Profesional të jenë me gradën Ushtar I – Ushtar IV, me kushtin që të kenë kryer kursin SIB dhe SIA.

Dokumentet e nevojshme:

1. Kërkesë me shkrim e nënshkruar nga kandidati, ku të përfshihet dhe arsyeja e ndjekjes së kursit.
2. Fotokopje e ID.
3. Të dhënat e personelit sipas formatit ushtarak të firmosur nga Shefi i Personelit të njësisë ku shërben.

Pikë kontakti:

Zyra e Personelit të Regjimentit të Operacioneve Speciale

Cel: 00355684846190

Tel: 532-1044

